



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

WITH FUNDING FROM



**AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION**



Ngacmimi seksual në Kosovë

Ngacmimi seksual në Kosovë

Nga Ariana Qosaj-Mustafa, Adelina Berisha, Nicole Farnsworth, dhe Iliriana Banjska

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
Prishtinë, Kosovë
2016

© Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, 2016

Autore: Ariana Qosaj-Mustafa, Adelina Berisha, Nicole Farnsworth, dhe Iliriana Banjska

ISBN 978-9951-8923-2-2

Printuar nga Night Design në Prishtinë, Kosovë, me printim ekologjik.

Ky hulumtim është financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim. Pikëpamjet e paraqitura nuk korrespondojnë domosdoshmërisht me pikëpamjet e Agjencisë Austriake për Zhvillim.

www.womensnetwork.org

Përmbajtja

Akronimet.....	2
Mirënjohje.....	3
Përmbledhje ekzekutive	4
Korniza ligjore.....	4
Përceptimet	4
Shtirja.....	4
Reagimi institucional.....	4
HYRJE	6
Metodat e hulumtimit	6
Rreth këtij raporti.....	7
KORNIZA LIGJORE PËR NGACMIMIN SEKSUAL NË KOSOVË	8
Ngacmimi seksual në ligjet në fuqi të Kosovës	8
Dispozitat e kodit penal të lidhura me ngacmimin	11
Procedurat për parashtrimin e ankesave për ngacmime.....	14
Përfundime	16
PERCEPTIMET PËR NGACMIMIN SEKSUAL.....	18
Perceptimet lidhur me ngacmimin seksual në vendin e punës	20
Perceptimet në lidhje me atë se kush mund të kryejë ngacmim seksual	21
Sipas njerëzve, pse ndodh ngacmimi seksual?	21
Përfundime	23
PËRHAPJA E NGACMIMIT SEKSUAL.....	24
Prevalenca gjatë jetës.....	24
Prevalenca në vitin 2014	27
Personat që shkaktuar ngacmim seksual ndaj respondentëve?	30
Ngacmimi seksual në punë	31
Ngacmimi seksual në shkolla	32
Pasojat e ngacmimit seksual	32
Reagimet e qytetarëve ndaj ngacmimit seksual.....	33
Përfundime	34
REAGIMET INSTITUCIONALE NDAJ NGACMIMIT SEKSUAL	35
Nëpunësit civilë në nivelin komunal	38
Shkollat dhe universitetet.....	39
Policia.....	40
Prokurorët.....	42
Gjykatësit.....	44
Mbrojtësit e Viktimave.....	46
Institucioni i Avokatit të Popullit.....	46
Përfundime	47
REKOMANDIME	48
Shtojca 1. Metodologjia e hulumtimit.....	51
Shtojca 2. Pyetësi.....	55
Shtojca 3. Lista e të intervistuarve	59
Bibliografia.....	64

Akronimet

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
ADA	Agjencia Austriake për Zhvillim
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DMNV	Divizioni për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave
KB	Kombet e Bashkuara
KE	Komisioni Evropian
KEDKG	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KiS	Kodi i Sjelljes
KP	Kodi Penal
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
LGBTQ	Lezbike, gej, biseksualë, transgjinorë apo queer
MV	Mbrojtja e Viktimave
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
QAP	Qendra për Aftësim Profesional
QPS	Qendra për Punë Sociale
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
QKSGj	Qendra Kosovare për Studime Gjinore
QRP	Qendra Rajonale e Punësimit
RAINN	Rrjeti Kombëtar për Dhunim, Abuzim dhe Incest
RrGGK	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

Mirënjohje

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës shpreh falënderimin e tij për të gjithë ata që janë përfshirë në këtë hulumtim, si qytetarëve ashtu edhe institucioneve që ofruan kohën, energjinë si dhe mendimet e tyre. RrGGK falënderon ekipin hulumtues të palodhur dhe të përkushtuar: Nicole Farnsworth (hulumtuese kryesore, MSc), Ariana Qosaj-Mustafa (eksperte ligjore), dhe ndihmës hulumtueset: Adelina Berisha, Iliriana Banjska, Nertila Qarri-Gërguri, dhe Antonia Hoidal. Gjithashtu, falënderojmë Erëblina Elezaj për përvojën e saj të çmuar dhe ekspertizën falas lidhur me analiza statistikore. Falënderim i veçantë shkon për Arbnora Kolgjerajn dhe Egzona Azemin për ndihmën e dhënë në intervistimin e institucioneve si dhe Kaltrina Kelmendin (asistent profesoreshë në Departamentin e Psikologjisë, Universiteti i Prishtinës) për ofrimin e mbështetjes dhe mbikëqyrjes psikologjike për ekipin hulumtues dhe respondentët e hulumtimit, sipas nevojës.

Falënderojmë praktikantët e mëposhtëm që kanë dhuruar disa ditë apo muaj të kohës së tyre për transkriptimin e intervistave: Alma Ademi, Diçe Rizvanolli, Erleta Morina, Rënea Hasani, Hana Rizvanolli, Lejla Cana, Nita Bislimi, Marigonë Vrajolli, dhe Miranda Muharremi. Po ashtu falënderojmë grupin këshillues dhe recensentët: Agjencinë për Barazi Gjinore pranë Zyrës së Kryeministrit (ABGj); Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE); Natasha Banfield; Driton Zeqiri, sociolog; Hana Marku, anëtare e RrGGK-së; Lina Andeer, këshilltare gjinore pranë Misionit të EULEX-it në Kosovë; si dhe Violeta Rexha, këshilltare gjinore pranë Misionit të EULEX-it në Kosovë.

U jemi shumë mirënjohës 46 anketuesve të cilët kanë punuar pa pushim për të përfunduar procesin e anketimit me kohë dhe në mënyrë profesionale: Adni Kukesi, Agnesa Haxhiu, Aida Gashi, Arbnora Kolgjera, Ardian Batusha, Bardha Çelaj, Beshir Seferi, Dafina Halili, Dardan Ahmeti, Diana Shaka, Driton Gusia, Dua Dauti Kadriu, Edon Gërbani, Egzona Azemi, Erisa Xhemajli, Fanol Ahmetaj, Fjolla Vukshinaj, Flamur Kadriu, Florent Thaci, Gyltene Osmani, Ilir Miftari, Iliriana Banjska, Jetbardha Selmani, Jeton Dukagjini, Jeton Jashari, Jovan Rikallo, Katarina Besova, Leutrim Shahini, Leyza Mripa, Luan Bajraj, Lulzim Hasari, Marina Milosevic, Mergim Gerbeshi, Mrika Rizvanolli, Nevenka Rikallo, Ramadan Sokoli, Roland Sylejmani, Shenoll Rexhepi, Srdjan Milosevic, Suzana Emini, Uran Haxhiu, Valdrin Misini, Vënera Cocaj, Vesna Stajic, Vilsona Blakaj, and Yllza Xheladini. Futja e të dhënave është bërë nga Abetare Qarri, Adelina Berisha, Din Terpun, Edona Vatoci, Elona Osmani, dhe Gentiana Halimi.

Përmbledhje ekzekutive

Korniza ligjore

Kosova ka një bollëk ligjesh, të cilat mund të konsiderohen si të aplikueshme lidhur me ngacmimin seksual. Në procedurat civile, ngacmimi seksual përkufizohet në Ligjin për Barazinë Gjinore dhe Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi. Edhe pse e përkufizon ngacmimin, Kodi Penal nuk përmban asnjë përkufizim specifik të ngacmimit seksual *per se*. Dispozitat e Kodit Penal, në fakt, ofrojnë mbrojtje të përparuar për viktimat e ekspozuara ndaj rreziqeve, duke përfshirë viktimat e abuzimit seksual. Rregulloret e brendshme në institucione të ndryshme dhe procedurat për raportimin e rasteve të ngacmimit seksual nuk janë plotësisht të qarta, duke e penguar kështu zbatimin e këtyre ligjeve. Kosovës i duhet të integrojë këtë shumësi ligjesh, të përfshijë një përkufizim më specifik të ngacmimit seksual në Kodin Penal, si dhe të krijojë procedura të qarta për raportim. Përndryshe, Kosovës do të vazhdojë t'i mungojë *de facto* zbatimi i këtyre ligjeve, duke përfshirë paditë individuale për diskriminim, diskriminim me bazë gjinore dhe ngacmim seksual.

Përceptimet

Një përqindje më e lartë e burrave sesa ajo e grave ka tendencën të identifikojë pjesën më të madhe të formave të ngacmimit seksual si të tilla. Më të moshuarit kanë prirje të kenë më shumë gjasa sesa më të rinjtë që të identifikojnë disa (edhe pse jo të gjitha) format e ngacmimit. Të pyetur lidhur me atë se çfarë nënkupton ngacmimi seksual për ta, 69.3% e të anketuarve konsiderojnë të tilla veprat kriminale, si përdhunimi, përdhunimi i mbetur në tentativë, forma këto të ngacmimit seksual. Më pak sesa gjysma e të anketuarve mendojnë se presioni për favore seksuale (49%); prekje, pickime ose shtyrje (49%); fishkëllima dikujt në rrugë (43.8%), janë forma të ngacmimit seksual. Edhe më të paktë janë kosovarët që i kanë konsideruar format e tjera të ngacmimit seksual si të tilla, çka lë të kuptohet se në përgjithësi ka një mungesë të sensibilizimit lidhur me atë se çka është ngacmimi seksual. Kjo mund të shkaktojë sfida në zbatimin e kornizës ligjore.

Kultura e “fajësimit të viktimës”, në rastet kur ka ngacmim seksual, është e përhapur gjerësisht, ku 74% e kosovarëve besojnë se “gratë u shkaktojnë vetë probleme vetes, duke u veshur dhe sjellë në mënyrë provokative.” Një numër pak më i lartë i grave sesa ai i burrave bien dakord me këtë pohim. Pothuaj një e treta e kosovarëve besojnë se njerëzit i ngacmojnë të tjerët kur janë të tërhequr prej tyre dhe se kjo sjellje është “në rregull”. Më shumë burra (35.4%) sesa gra (26.9%) kanë prirje të pajtohen me mendimin se kjo sjellje nuk përbën problem (është “në rregull”). Më tej, si tek burrat, ashtu edhe tek gratë, ekziston një besim i përhapur që “të rejave iu pëlqen kur i ngacmojnë” (40.5%).

Shtrirja

Vlerësohet se 48.5% e kosovarëve kanë përjetuar ndonjë formë të ngacmimit seksual gjatë jetës së tyre, ndërkohë që vetëm në vitin 2014, 45.2% e kanë përjetuar këtë lloj ngacmimi. Gratë (64.1% e grave) kanë konsiderueshëm më shumë gjasa që të kenë përjetuar ngacmim seksual sesa burrat (32.5%), ndërsa më të rinjtë raportojnë se kanë përjetuar ngacmim më shumë sesa më të rriturit në moshë. Forma më e zakonshme e ngacmimit, të cilën e kanë përjetuar respondentët, ishte kur dikush bënte komente, shaka, apo gjeeste seksuale të padëshiruara, duke përfshirë edhe ato gjatë ecjes në rrugë. Respondentët kryesisht janë ngacmuar nga persona të panjohur, por edhe nga të njohurit, shokët, kolegët e punës, mësimdhënësit, pronarët në vendin e punës, si dhe partnerët e tyre. Si viktimat, ashtu edhe dëshmitarët e ngacmimit kanë prirje ta mospërfillin atë. Vetëm 4.1% e të gjithë respondentëve i kanë raportuar rastet e ngacmimit seksual te autoritetet ose njihtin dikë që kishte vepruar kështu.

Reagimi institucional

Pjesa më e madhe e përfaqësuesve të institucioneve kanë prirjen të mos kenë njohuri lidhur me ngacmimin seksual, përkufizimin e tij, kornizën përkatëse ligjore, si dhe procedurat e duhura për adresimin e tij. Kjo e pengon aftësinë e tyre për t’iu përgjigjur me efektivitet rasteve të ngacmimit

seksual. Ata kanë prirjen ta keqkuptojnë ngacmimin seksual si përdhunim apo sulm seksual, ndërkohë që format “më pak të rënda” janë ose të panjohura, ose konsiderohen si të parëndësishme. Disa përfaqësues të institucioneve i kanë fajësuar viktimat për ngacmimin seksual. Fakti që fare pak raste janë raportuar apo dokumentuar nga institucionet e bën të vështirë vlerësimin e reagimit institucional.

HYRJE

Ngacmimi seksual mbetet një koncept mjaft i ri në Kosovë. Në vitin 2014, një veprim i vogël në kuadrin e fushatës “Nata është e jona” (*Take Back the Night*), i habiti aktivistët për të drejtat e grave, duke nxitur debate të nxehta në medien sociale. Pati histori që dolën nga errësira në dritë. Rinia bëri thirrje për reforma. Pjesa tjetër e të rinjve shprehej që kishte shumë zhurmë për asgjë. Aktivistët e kuptuan se qytetarët e Kosovës nuk ishin të mirë-informuar lidhur me ngacmimin seksual dhe përhapjen e tij. Në një studim të realizuar në vitin 2010 nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj), është hulumtuar ngacmimi seksual në radhët e shërbyesve civilë. Megjithatë, përtej institucioneve publike, nuk kishte të dhëna të disponueshme, për shembull lidhur me ngacmimin në rrugë apo në shkolla. Me këtë çështje, nga sa dihet, nuk është marrë asnjë hulumtim tjetër.

Debati që u soll rreth fushatës “Nata është e Jona”, i përforcoi bindjet e RrGGK-së se ekzistonte një nevojë e madhe për të matur sensibilizimin dhe qëndrimet e qytetarëve, si dhe incidencën e ngacmimit seksual në Kosovë. Ky hulumtim ka për qëllim adresimin e mungesës së të dhënave lidhur me ngacmimin seksual në Kosovë. Gjithashtu, me anë të këtij hulumtimi synohet zbatimi i kornizës përkatëse ligjore nga ana e institucioneve publike përgjegjëse. Më konkretisht, RrGGK-ja ka pasur për synim t’iu përgjigjet këtyre pyetjeve kërkimore:

1. Cila është incidenca e ngacmimeve seksuale në rrugë, në vendin e punës, dhe në mjediset universitare?
2. Cila është shkalla e njohurive të qytetarëve të Kosovës lidhur me të drejtat që ata kanë, lidhur me ngacmimin seksual?
3. Cilat janë qëndrimet e qytetarëve të Kosovës lidhur me ngacmimin seksual?
4. Cili është reagimi institucional ndaj rasteve të ngacmimit seksual?

Në këtë raport, RrGGK-ja merr një qasje holistike, me qëllim që të hetojë ngacmimin seksual. Gjatë marrjes me përkufizimet ligjore të ngacmimit, në pajtim me ligjet e Kosovës, ngacmimi seksual mund të kuptohet në terma më të përgjithshëm edhe si formë e dhunës seksuale. Më tej, format e ndryshme të dhunës seksuale mund të ndërlidhen me njëra-tjetrën. Për shembull, ngacmimi seksual mund të jetë pjesë dhe/ose mund të çojë në forma të tjera të dhunës seksuale, siç janë sulmi seksual apo përdhunimi. Dhuna seksuale mund të përfshijë si dhunën fizike, ashtu edhe atë psikologjike. Për të ndërmarrë një qasje holistike në funksion të kuptimit të ngacmimit seksual, si dhe për të adresuar mungesën absolute të informatave lidhur me shkallën e përdhunimit dhe formave të tjera të dhunës seksuale në Kosovë, në këtë raport, RrGGK-ja u bën një vështrim të përgjithshëm e të shkurtër formave të tjera të dhunës seksuale *përtej* ngacmimit seksual, duke përfshirë përdhunimin dhe sulmin seksual.

Metodat e hulumtimit

Ky hulumtim është pjesë e një hulumtimi më të gjerë që RrGGK-ja ka kryer që prej fillimit të shkurtit të vitit 2015, me synim matjen e përhapjes së dy formave të dhunës me bazë gjinore: dhunës në familje dhe ngacmimit seksual.¹ Në hulumtim janë përdorur metoda të përziera, duke përfshirë shqyrtimin e kornizës ligjore në funksion të identifikimit të boshllëqeve të mbetura në kornizën ligjore dhe zbatimin e saj; shqyrtimin e të dhënave statistikore të nxjerra nga institucionet përkatëse; si dhe një anketim të 1,315 kosovarëve (51% gra dhe 49% burra), në funksion të matjes së vetëdijesimit, qëndrimeve dhe incidencës së ngacmimit seksual. Hulumtimi është kryer si në zonat rurale (59.2%) ashtu edhe në ato urbane (40.8%). Të gjitha grupet etnike janë përfaqësuar përmes përdorimit të Metodës së Mostrimit të Rastësishëm me Shumë Strate. Në hulumtim janë përfshirë edhe intervista me

¹ Vitin e shkuar, RrGGK-ja publikoi raportin e parë të nxjerrë nga ky hulumtim, i cili përqendrohet në dhunën në familje: RrGGK, *Mjaft më me Arsyetime: Analizë e qëndrimeve, incidencës dhe reagimeve institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë*, Prishtinë: RrGGK, 2015: <http://www.womensnetwork.org/documents/20151124105025644.pdf>.

rreth 200 përfaqësues të ndryshëm të institucioneve dhe shoqërisë civile. Ky hulumtim ka marrë përkrahjen bujare të Agjencisë Austriake për Zhvillim dhe kontribute të konsiderueshme në të mira materiale nga disa individë të përkushtuar. Për më shumë informata lidhur me metodologjinë e hulumtimit, ju lutemi t'i referoheni Shtojcës I.

Rreth këtij raporti

Në këtë raport, më së pari shqyrtohen ligjet në fuqi, të lidhura me ngacmimin seksual në Republikën e Kosovës, analizohen mangësitë në kornizën ligjore, dhe ofrohen rekomandime për adresimin e tyre. Kapitulli i dytë shqyrton vetëdijesimin, perceptimet dhe qëndrimet e kosovarëve ndaj ngacmimit seksual. Në kapitullin e tretë të raportit, shqyrtohet shtrirja e ngacmimit seksual në Kosovë. Në të katërtin, shqyrtohen reagimet institucionale ndaj ngacmimit seksual. Ky raport përfundon me disa rekomandime për kornizën ligjore si dhe për palët përkatëse të interesit, në funksion të adresimit më të mirë të ngacmimit seksual në Kosovë. Publikimi përfshin edhe shtojcat, ku ka më shumë informata lidhur me metodologjinë e hulumtimit (Shtojca I), instrumentet kërkimore (Shtojca 2), si dhe një listë e respondentëve të intervistuar (Shtojca 3).

KORNIZA LIGJORE PËR NGACMIMIN SEKSUAL NË KOSOVË

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton dinjitetin e cilitdo, si bazë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.² Në Kushtetutë gjithashtu theksohet se me qëllim që Kosova të zhvillohet në mënyrë demokratike, është e nevojshme që të sigurohet barazia gjinore, si vlerë themelore e shoqërisë. Kjo përfshin “mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.”³ Këto parime themelore pasqyrohen në konventa ndërkombëtare, të tilla si Konventa e Kombeve të Bashkuara (OKB) për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEDKG), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe klauzolat për mos-diskriminimin në konventa të tjera, dhe të gjitha këto janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë, mbështetur në klauzolën e Kushtetutës lidhur me zbatimin e drejtpërdrejtë të këtyre parimeve në rendin juridik të Kosovës.⁴

Megjithatë, përdorimi i parimeve ndërkombëtare në praktikën gjyqësore të gjykatave në Kosovë, është një praktikë e rrallë, për të mos thënë inekzistente. Vetëm gjatë viteve të fundit, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka qenë pionere e përdorimit të praktikës gjyqësore ndërkombëtare në vendimet e saj.⁵ Edhe pse përdorimi i konventave ndërkombëtare, të cilat zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe praktikës gjyqësore ndërkombëtare nuk praktikohet gjerësisht në gjykatat e Kosovës, ekzistenca e këtyre dispozitave është, gjithsesi, e rëndësishme si referencë në raste të ardhme të kërimit të drejtësisë, të hapura nga qytetarët e Kosovës, duke përfshirë këtu edhe paditë për rastet e ngacmimit seksual.

Ngacmimi seksual në ligjet në fuqi të Kosovës

Parimet udhëheqëse të konventave ndërkombëtare, të zbatuara përmes protokolleve dhe rekomandimeve përkatëse, zbatohen në kornizën ligjore të Kosovës.⁶ Në rekomandimin e përgjithshëm nr. 19 të KEDKG-së, ngacmimi seksual kundër grave përkufizohet si “Sjellje seksuale e padëshiruar, si kontakti apo afrimi fizik, vërejtjet me ngjyresa seksuale, shfaqja e pornografisë dhe kërkesave seksuale, qoftë me fjalë, qoftë me veprime.” Më tej, KEDKG-ja thekson se diskriminimi i ndaluar me Konventë nuk kufizohet vetëm në veprimet nga qeveria. Edhe institucionet shtetërore kanë përgjegjësi të ndërmarrin masa të duhura dhe të mbajnë përgjegjësi për “aktet private, në rast se dështojnë të veprojnë me kujdes të shtuar për parandalimin e shkeljeve apo t'i ndëshkojnë aktet e dhunës, si dhe për ofrimin e kompensimit.”⁷

Gjithashtu, direktivat e Bashkimit Evropian (BE) e përkufizojnë ngacmimin seksual në rastin kur ndodh “çdo formë e sjelljes së padëshiruar verbale, jo-verbale apo fizike, me natyrë seksuale, me qëllim apo ndikim në cenimin e dinjitetit të një personi, kryesisht përmes krijimit të një atmosfere kërcënuese, armiqësore, degraduese, poshtëruese apo fyese.” Këto akte konsiderohen diskriminim me bazë gjinore

² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 23, marrë nga: <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

³ Ibid, neni 7, paragrafi 2.

⁴ Ibid, neni 22.

⁵ Shihni, për shembull, praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cituar në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në rastin KI41/12, parashtrues të kërkesës Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Në këtë rast të cituar shpesh, Gjykata Kushtetuese e Kosovës iu referua KEDKG-së në vendimin e saj akullthyes për rastin e Diana Kastratit. Gjykata Kushtetuese vendosi që vonesa e gjykatës në lëshimin e urdhrit për mbrojtje, i parashikuar me ligj, ka shkelur të drejtën e njeriut për jetën, e cila garantohet nga konventat ndërkombëtare të cilat janë të aplikueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në legjislacionin e brendshëm të Kosovës.

⁶ Ibid.

⁷ OKB, KEDKG, Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 19 për Dhunën ndaj Grave, paragrafi 9, marrë nga: <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/recommendations/recomm.htm>.

dhe shtetet anëtare të BE-së inkurajohen t'i ndalojnë këto forma të diskriminimit.⁸ Mbështetur në parimin e dinjitetit njerëzor dhe dinjitetit të grave, qasja e BE-së përqendrohet në dënimin dhe ndalimin e ngacmimit seksual në punë, duke përfshirë atë që lidhet me mundësitë e punësimit apo ushtrimit të profesionit.

Ligjet e brendshme të Kosovës janë të harmonizuara me standardet ndërkombëtare, dhe përdorin formulimin e Direktivave të BE-së për përkufizimin e ngacmimit, duke përfshirë sjelljen me natyrë seksuale, sipas legjislacionit të Kosovës kundër diskriminimit. Ngjashëm me përkufizimin në ligjin e vjetër kundër diskriminimit, të vitit 2004, Ligji i ri nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i miratuar në vitin 2015, e konsideron ngacmimin si formë diskriminimi, të përkufizuar në nenin 4, paragrafi 1.3, atëherë:

kur një sjellje e padëshirueshme (që përfshin por, nuk kufizohet në sjellje të natyrës së padëshirueshme seksuale dhe/apo psikologjike, që ka për qëllim apo pasojë shkeljen e dinjitetit të personit dhe krijimin e ambientit frikësues, armiqësor, degradues, nënçmues apo fyes) mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.

Diskriminimi mund të jetë i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë. Diskriminimi i drejtpërdrejtë “konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme.” Seksi, gjinia, identiteti gjinor, dhe orientimi seksual janë mes “bazave” të renditura, mbi të cilat mund të diskriminohen personat.⁹

Në rastet kur personat pretendojnë se ka pasur ngacmim seksual, viktimizimi mund të vazhdojë edhe më tej, ndërkohë që Ligji i Kosovës për Mbrojtjen nga Diskriminimi e ndalon edhe këtë diskriminim, nëse “personi personi përjeton trajtim të pafavorshëm apo pasoja negative si reagim ndaj ankimit apo mos ankimimit (procedurave të filluara) apo veprimeve me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë, ose në rastet kur personi i tillë ofron informacione, dëshmi apo ndihmë në lidhje me ankesën ose procedurën në rast të diskriminimit.”¹⁰ Ligji zbatohet për të gjithë personat, duke përfshirë ata juridikë, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat, në lidhje me çfarëdo veprimi apo mosveprimi që shkel të drejtat e personave në qasjen apo kushtet për qasje në punësim, trajnime profesionale, ngritje në detyrë, apo qasje te të mirat, shërbimet dhe mbrojtja sociale.¹¹ Ligji i ri parashikon edhe një procedurë të re për parashtrimin e padive në gjykatat kompetente jo vetëm nga individët, por edhe nga një grup individësh, të cilët mund të ankohen së bashku se kanë qenë të diskriminuar, duke u mbështetur në argumentet sipas nenit 1 të Ligjit.¹²

Gjithashtu, në harmoni me direktivat e BE-së, Ligji parashikon procedurën për ndryshimin e barrës së provës. Kjo do të thotë se personat që ankohen për diskriminim apo ngacmim para gjykatës apo ndonjë institucioni tjetër juridik, ia lënë barrën e provës personit kundër të cilit parashtrohet ankesa. Ky person duhet të provojë se akuzat kundër tij apo saj nuk janë të vërteta, përmes ofrimit të provave që dëshmojnë se nuk ka pasur shkelje.¹³ Kjo procedurë nuk përdoret në procedurën penale

⁸ Shihni Direktivën e Bashkimit Evropian 2002/73/EC për Trajtimin e Barabartë në Punësim për Burrat dhe Gratë, të plotësuar nga Direktiva 2006/54/EC e Bashkimit Evropian, e datës 5 korrik 2006 për Zbatimin e Parimit të Trajtit të Barabartë të Grave dhe Burrave në Punësim dhe Profesion, marrë nga: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32002L0073>. Krahas kësaj, Direktiva e Bashkimit Evropian, e vitit 2004, për zbatimin e Parimit të Trajtit të Barabartë të Grave dhe Burrave në Qasjen në Marrjen e Shërbimeve dhe Përdorimin e të Mirave, detajon më tej qasjen e barabartë të grave dhe burrave në shërbime, duke u mbështetur në parimin e mos-diskriminimit.

⁹ Diskriminimi mund të jetë: “në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër” (Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, neni 1.1 dhe 4, marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-021%20sh.pdf>).

¹⁰ Ibid, neni 4, paragrafi 1.5.

¹¹ Ibid, neni 2.

¹² Ibid, neni 13.

¹³ Ibid, neni 20, paragrafi 2.

dhe as në procedurën kundërvajtëse.¹⁴ Gjatë intervistave, RrGGK-ja nuk ka gjetur prova të ndonjë rasti ku barra e provës kishte rënë mbi kryerësin e akuzuar.

Ligji i vjetër Kundër Diskriminimit parashikonte një gamë sanksionesh për shkeljet e ligjit nga ana e personave juridikë, personat fizikë, kontraktorët e pavarur, si dhe personat që ushtrojnë funksione publike, me gjoba që varionin nga 500 në 10.000 euro.¹⁵ Ligji i ri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i ka zvogëluar sanksionet në mënyrë të ndjeshme, dhe tani ato variojnë nga 400 euro deri në maksimumi 1,350 euro.¹⁶ Krahas kësaj, procedurat e ndërmjetësimit dhe pajtimit parashikohen të përdoren nga individët, sipas zgjedhjes së tyre të lirë.¹⁷ Çdo padi që parashtrohet për shkak të diskriminimit, në procedurë civile, duhet të trajtohet brenda afatit kohor më të shkurtër, në pajtim me rregullat e përcaktuara në ligjin për procedurën kontestimore.¹⁸

Shkeljet që kanë të bëjnë me veprat penale trajtohen në pajtim me Kodin Penal të Kosovës. Megjithatë, ligji i ri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk specifikon se cilat vepra përbëjnë vepra penale.¹⁹ Kompensimi mund të realizohet po ashtu përmes padive në gjykatat civile, të cilat urdhërojnë kthimin në gjenden e mëparshme, përpara ndodhjes së diskriminimit, ose një kompensim të përshtatshëm për dëme materiale apo jo materiale. Mënyra e llogaritjes së kompensimit të duhur nuk është specifikuar në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Për më shumë sesa një dekadë që prej miratimit të tij në vitin 2004, zbatimi i ligjit të vjetër Kundër Diskriminimit është penguar nga procedurat gjyqësore dhe administrative të paqarta. Duket se mbi bazën e ligjit të vjetër, fare të pakta kanë qenë paditë e parashtruara, ndërkohë që gjykatat rrallë herë kanë ndëshkuar me gjoba.²⁰ Edhe OSBE-ja ka raportuar se në gjykatat e Kosovës janë parashtruar shumë pak padi për shkak të diskriminimit.²¹ Në kërkesat e BE-së, që institucionet e Kosovës duhet të plotësojnë në kuadrin e Udhëzimeve për Liberalizimin e Vizave dhe në kushtet për lëvizjen e lirë, është kërkuar në mënyrë specifike zbatimi i një ligji të ri kundër diskriminimit, Ligjit për Avokatin e Popullit, dhe Ligjit për Barazinë Gjinore, me qëllim që të adresohen mbivendosjet në këto ligje dhe të përmirësohet zbatimi i tyre.²² Të tri këto ligje janë rishikuar në vitin 2015 dhe në ligjin e ri janë bërë përpjekje për të qartësuar procedurat, të cilat deri më tani kanë qenë të paqarta.

Ngacmimi seksual është përkufizuar dhe ndaluar edhe me ligjin e ri të Kosovës për Barazinë Gjinore, të miratuar në vitin 2015.²³ Ligji i ri përcakton dhe e ndalon ngacmimin seksual, si “çfarëdo forme të sjelljes së padëshiruar verbale, jo verbale, apo fizike me natyrë seksuale, me qëllim apo pasojë preken apo shkeljen e dinjitetit të një personi, dhe për të krijuar një mjedis frikësues, armiqësor, degradues, poshtërues apo fyes”.²⁴ Gjithashtu, pas ankesës së viktimës për shkak të ngacmimit, punëdhënësve iu ndalohet ta viktimizojnë më tej viktimën (p.sh. duke i pushuar nga puna apo duke i ulur në pozitë).²⁵ Në krahasim me Ligjin e vjetër për Barazinë Gjinore të vitit 2004, masat ndëshkuese të parashikuara me ligjin e ri janë ulur në mënyrë të konsiderueshme. Ligji i vjetër parashikonte sanksione që varionin nga 5,000 në 10,000 euro për punëdhënësit dhe 1,000 deri në 3,000 euro për personat përgjegjës.²⁶ Aktualisht, gjobat janë shumë më të ulëta: nga 300 në maksimumi 900 euro.²⁷ Gjobat e arkëtuara depozitohen në buxhetin e Kosovës. Gjithashtu, ligji parashikon se aktet e

¹⁴ Ibid, paragrafi 3.

¹⁵ Ligji Kundër Diskriminimit, 2004, neni 9.

¹⁶ Neni 23.

¹⁷ Neni 21.

¹⁸ Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, neni 16.

¹⁹ Neni 17.

²⁰ Ndërkohë që institucionet kanë mirëmbajtur pak të dhëna të konsoliduara lidhur me këtë, kjo mbështetet në vëzhgimet e përgjithshme të bëra nga të intervistuarit. Për më shumë informata, shihni më poshtë pjesën për reagimin institucional.

²¹ Shini, Misioni i OSBE-në në Kosovë, “Zbatimi i Ligjit Kundër Diskriminimit: Sfidë për Kosovën,” 2007, marrë nga:

<http://www.osce.org/kosovo/25854?download=true>.

²² Shihni *Raportin e dytë të progresit të Kosovës në përmbytjen e kërkesave për Udhëzimet e Liberalizimit të Vizave*, fq. 7, marrë nga: http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-is-new/news/news/docs/second_commission_assessment_en.pdf.

²³ Ligji i Kosovës për Barazinë Gjinore, nr. 05/L-020, marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-020%20sh.pdf>.

²⁴ Ibid, neni 3, paragrafi 1.12.

²⁵ Ibid, neni 4, paragrafi 6.

²⁶ Ligji nr. 2004/2 për Barazinë Gjinore në Kosovë, neni 17.3.

²⁷ Ligji i Kosovës për Barazinë Gjinore, neni 23.

diskriminimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, sikurse parashikohen në ligj, duhet të sanksionohen nga gjykatat kompetente, të cilat duhet të hartojnë procedura të shkeljes, me qëllim shqiptimin e sanksioneve. Megjithatë, ligji nuk përcakton në mënyrë specifike procedurat e shkeljes, gjë e cila paraqet vë në rrezik zbatimin e ligjit. Në përgjithësi, sanksionet që parashikohen në ligjin e ri janë më të +dobëta sesa ato në ligjin e vjetër.

RrGGK-ja nuk ka mundur të gjejë asnjë rast në praktikën administrative apo juridike në Kosovës ku punonjësit apo shkelësit janë dënuar me gjoba për ngacmim seksual, në pajtim me dispozitat e Ligjit të vjetër të vitit 2004 për Barazinë Gjinore apo Ligji Kundër Diskriminimit.²⁸ Prokuroria e Shtetit ka deklaruar vetëm tri raste për periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2014, ku prokurorët kanë kërkuar masa ndëshkimore në rastet e veprave penale kundër integritetit seksual. Zbatimi i ligjeve të reja do të kërkojë monitorim për së afërmi, me qëllim ai të mos mbesë sfidë e vazhdueshme për Kosovës në zbatimin e standardeve për të drejtat e njeriut, në mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe mundësive të barabarta, të garantuara me Kushtetutë.

Një ligj tjetër që ofron mbrojtje kundër diskriminimit është Ligji i Kosovës për Shërbimin Civil. Ky ligj parashikon parimet themelore për t'u bërë pjesë e shërbimit civil, mbrojtjen nga diskriminimi në vendin e punës, dhe avancimin në karrierë. Kjo është në pajtim me parimin më të përgjithshëm të mos-diskriminimit, i cili, brenda shërbimit civil, e ndalon diskriminimin në bazë gjinore apo orientimi seksual. Krahas kësaj, inkurajohet ofrimi i mundësive të barabarta me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë të gjinive në shërbimin civil.²⁹ Megjithatë, kjo dispozitë ka një natyrë të përgjithshme, dhe thjesht krijon bazat lidhur me atë se çfarë konsiderohet diskriminim. Për sa u takon shkeljeve, nuk janë përmendur sanksione, edhe pse mund të argumentohet se Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi ka mundur të zbatohet.

Dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi zbatohen edhe lidhur me punëdhënësit dhe marrëdhëniet e tyre me të punësuarit në sektorin publik dhe privat, në pajtim me Ligjin e Punës të Kosovës.³⁰ Ligji i Punës ndalon çdo formë të diskriminimit lidhur me punësimin dhe ushtrimin e profesionit, kur fjala është për rekrutimin, trajnimin, ngritjen në detyrë, termat dhe kushtet e punësimit, duke përfshirë edhe masat disiplinore, marrëdhëniet kontraktuale, si dhe marrëdhëniet e tjera të punës. Në Ligjin e Punës ka një klauzolë e cila detajon se në procedurën juridike, gjokat, në rast se personat fizikë apo juridikë nuk i përfillin dispozitat e ligjit, variojnë nga 100 deri në 10,000 euro.³¹

Dispozitat e kodit penal të lidhura me ngacmimin

Kodi penal nuk e përcakton ngacmimin seksual *per se*, por ofron përkufizime të rëndësishme në disa nene. Për shembull, në nenin 186, ngacmimi përcaktohet si:

[Një] sjellje e vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme ose komunikim me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmeve apo kafshëve shtëpiake ose kushdo që vë tjetrin nën vëzhgim me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmeve apo kafshëve shtëpiake; dhe gjatë këtyre veprimeve vë atë person nën frikë të arsyeshme nga vdekja, lëndim të rëndë trupor, dëmtim të rëndë të pasurisë ose nën shqetësim të madh emocional,

Kodi Penal gjithashtu shpjegon se vëmendja dhe komunikimi sipas përkufizimit të ngacmimit, nënkupton “përcjelljen apo qëndrimin në pritje; shfaqjen e vazhdueshme të shtëpia, shkolla, puna apo qendra

²⁸ Shihni Orgut Consulting, *Profili Gjinor i Kosovës*, për Ambasadën Suedeze, Prishtinë: 2014, marrë nga: http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Profili%20Gjinor%20i%20Vendit_2014%20-ALB.pdf; dhe “Norma”, *Hulumtimi dhe Monitorimi i Zbatimit të Ligjit për Barazinë Gjinore*, Prishtinë: Norma, 2011, fq. 18. Gjithashtu, shihni edhe Luljeta Demolli për QKSGj-në, *Perceptimet e shërbyesve civilë lidhur me ngacmimin seksual në vendin e punës*, Prishtinë: QKSGj, 2010, fq. 10.

²⁹ Ligji i Kosovës për Shërbimin Civil, nr. 03/L-149, neni 5, marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-149-alb.pdf>.

³⁰ Ligji i Punës nr. 03/L-212, neni 5.5.

³¹ Ibid, neni 92.

rekreative; përsëritjen e thirrjeve telefonike; dërgimin apo lënien e porosive; dërgimin e mesazheve telefonike, letrave postare apo postës elektronike; ose lënien apo dërgimin e dhuratave të padëshiruara apo të gjësendeve tjera.”³² Për ngacmim, personat mund të dënohen me burgim deri në tri vjet ose me gjobë. Nëse kjo shkelje kryhet ndaj një personi me të cilin kryesi ka qenë apo është në marrëdhënie familjare ose ndaj një ish anëtar apo anëtar aktual të familjes, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.³³

Kodi Penal përmban edhe mjete të tjera të mbrojtjes, nëse aktet ndodhin kundër viktimave të cenueshme, të cilat parashikojnë dënime më të larta për disa krime. Kodi e përcakton “viktimën e ndjeshme” si “fëmijë, person me aftësi të kufizuara fizike apo mendore, person me aftësi të zvogëluar, grua shtatzënë ose partner familjar.”³⁴ Edhe pse ngacmimi seksual nuk përmendet në mënyrë tekstuale, viktimat e ndjeshme të krimit, ku përfshihet ngacmimi, abuzimi seksual, ose cenimi i integritetit seksual, mund të jenë subjekt i mjeteve mbrojtëse të mëtejme.

Sipas nenit 198, ankesat për rastet e keqtrajtimit mund të bëhen nga persona që ushtrojnë detyrat e tyre zyrtare apo autorizimet publike, siç janë zyrtarët që abuzojnë me pozitën apo detyrën, që keqtrajtojnë, kërcënojnë, apo fyejnë rëndë dinjitetin e një personi tjetër. Në këto raste, zyrtarët do të ndëshkohen me burim deri në tri vite.³⁵ Nëse në këto raste është dhunuar ndonjë fëmijë, kjo konsiderohet si rrethanë rënduese për kryerësin dhe burgimi është më i gjatë: nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.³⁶ Në ligj, përkufizimi i asaj se çka përbën keqtrajtim nga persona gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, është i paqartë. Gjithashtu, as mënyra se si mund të cenohet konkretisht dinjiteti i një personi nuk përcaktohet qartë në Kodin Penal.

Kërkesa për “model” apo vepra “të përsëritura” është problematik, në kuptim që ngacmimi, duke përfshirë në mënyrë të veçantë ngacmimin seksual, mund të ndodhë një herë të vetme dhe mund të mos jetë domosdoshmërisht pjesë e një modeli sjelljesh. Pavarësisht nëse ndodh një herë të vetme apo shumë herë, ngacmimi duhet të ndiqet penalisht. Në të njëjtën kohë, shprehja “me qëllim që”, dukshëm e komplikon përkufizimin e ngacmimit. “Qëllimi” i një personi që kryen veprën e ngacmimit mund të jetë i vështirë të provohet në gjykatën e krijuar në bazë të ligjit dhe, me gjithë sinjeritetin, qëllimi nuk duhet të kërkohej si provë lidhur me atë nëse ka pasur ngacmim, sepse shërben vetëm për arsyen se pse personi e ka bërë krimin dhe jo për atë nëse vetë krimi është kryer. Më tej, edhe kërkesa që shqetësimet emocionale të jenë “thelbësore” duket e panevojshme; duhet të merret parasysh çdo shqetësim emocional që është shkaktuar nga ngacmimi.

Ndërkohë që “shqetësimet esenciale emocionale” nuk janë përkufizuar në mënyrë specifike, ndoshta mund të demonstron nëse, për shembull, gjykata duhet të urdhërojë kryerjen e ndonjë ekspertize apo nëse psikologu mund të ofrojë një vlerësim. RrGGK-ja nuk gjeti gjati asnjë shembull të pretendimeve për stres thelbësor emocional, në rastet e ngacmimit. Vetëm në një rast, Mbrojtësi i Viktimës raportonte se shqetësimet emocionale ishin paraqitur si prova materiale në gjykatën e Mitrovicës me rastin e trajtimit të rastit të një vajze minorene, e cila ngrii akuza kundër drejtorit të saj të shkollës.³⁷

Vetëm në një rast, Mbrojtësi i Viktimës e ka ftuar një psikolog gjatë procesit gjyqësor për të folur lidhur me atë nëse një vajzë kishte përjetuar shqetësime serioze emocionale si rezultat i ngacmimit seksual. Psikologu vlerësonte se: “Nga momenti kur ka ndodhur ngacmimi, ajo [viktima] ka përjetuar shqetësime emocionale, si probleme me gjumin, probleme me oreksin, si dhe probleme në nxënie, të cilat kanë cenuar notat e saj të mira, meqenëse dikur ka qenë studente shumë e mirë. Gjatë kësaj periudhe, ajo nuk ka arritur të studiojë.” Sipas Mbrojtësit të Viktimës, gjykata i pranoi këto elementë si prova, kryerësi u dënua me 3.5 vite burgim. RrGGK-ja nuk ka mundur të gjejë ndonjë rast tjetër në të cilin shqetësimi emocional i fortë është përdorur në gjykatë si provë.

³² Kodi Penal i Kosovës, neni 186, paragrafi 4.

³³ Ibid, neni 186, paragrafi 2.

³⁴ Ibid, neni 120, paragrafi 37, marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Kodi%20penal.pdf>.

³⁵ Ibid, neni 198.

³⁶ Ibid, neni 198, paragrafi 2.

³⁷ Intervistë e RrGGK-së me një Mbrojtës të Viktimës, 2015.

Duke marrë parasysh dykuptimësitë në përkufizimin aktual të ngacmimit, RrGGK-ja do të propozonte rishikimin e tij, në funksion të qartësimit, si më poshtë:

Çdo akt i padëshiruar, vëmendje apo komunikim, që e vë personin tjetër nën mbikëqyrje; e ngacmon atë; e kërcënon; e lëndon; ia dëmton pasurinë; përfshin kërcënime për dëmtim të pasurisë, lëndimin, apo vrasjen e një personi të familjes së atij personi apo kafshëve të përkëdhelura të tij/saj; dhe/ose e vë personin tjetër në një situatë të frikës së arsyeshme nga vdekja, lëndimeve të rënda trupore, dëmtimi i pasurisë, apo shqetësimet emocionale. Vëmendja apo komunikimi përfshin: qëndrimin në pritje, shfaqjen e përsëritur në shtëpi, shkollë, vendin e punës apo vend për çlodhje; bërjen e telefonatave të përsëritura; dërgimin apo lënien e mesazheve, duke përfshirë edhe ato përmes medias sociale; dërgimin e mesazheve tekst; letrave postare apo e-mailit; ose lënien apo dërgimin e dhuratave apo artikujve të tjerë të padëshiruar.

Krahas kësaj, në Kodin Penal duhet të përfshihet, me sanksione, një përkufizim i qartë i ngacmimit seksual, në harmoni me përkufizimet e ngacmimit seksual në ligje të tjera.

Përtej ngacmimit dhe keqtrajtimit, Kodi Penal e përkufizon “sulmin seksual” në nenin 232 si akte të cilat përfshijnë:

Prekjen e personit tjetër me qëllim seksual ose e cjtjen e personit të tillë që të prekë kryesin apo personin tjetër për qëllim seksual, pa pëlqimin e personit të tillë [ose kur] kryesi e di që personi është posaçërisht i ndjeshëm për shkak të moshës, aftësive të kufizuara mendore apo fizike, çrregullimit fizik apo mendor, paaftësisë ose shtatzënisë.³⁸

Në këto raste, dënimi me burgim varion nga një deri në shtatë vite. Në rastet kur kryesi është mësimdhënës, udhëheqës fetar, profesionist i kujdesit shëndetësor, person të cilit i është besuar rritja apo kujdesi për personin e tillë ose që në ndonjë mënyrë tjetër ka autoritet ndaj personit, burgimi parashikohet të jetë së paku dhjetë vjet ose i përjetshëm.³⁹ Sulmi seksual përfshin edhe rrethanat e prekjes së personit tjetër në një mënyrë seksuale dhe për qëllime seksuale.⁴⁰

Dispozitat e tjera përkatëse penale janë përdorimi ose përfshirja e fëmijëve në bërjen apo prodhimin e performancave “të gjalla”⁴¹ të një natyre seksuale apo prodhimi i pornografisë me fëmijë, për të cilat kryerësit dënohen nga një deri në pesë vite burgim. Krahas kësaj, edhe shitja, shpërndarja, promovimi, shfaqja dhe vënia në dispozicion e pornografisë me fëmijë konsiderohen si vepër penale, me dënim që varion nga gjashtë muaj në pesë vjet.⁴²

Më tej, ngacmimi seksual mund të përfshirë apo çojë në vepra kundër integritetit seksual të një personi. Kodi Penal i Kosovës gjithashtu njih shfrytëzimin e situatës në të cilën personi është i cenueshëm apo ku siguria e tij apo e saj është në rrezik, duke përfshirë këtu rastin ku kryerësi është në pozitë autoriteti ndaj personit apo është kujdestar, mësimdhënës, udhëheqës fetar, apo profesionist i kujdesit shëndetësor.⁴³ Në këto rrethana, veprat kriminale si⁴⁴ përdhunim, sulm seksual, dhe degradim i

³⁸ Kodi Penal i Kosovës, neni 232, paragrafi I dhe 3.7.

³⁹ Ibid, neni 232, paragrafi 3.10.

⁴⁰ Ibid.

⁴¹ Performanca e gjallë përkufizohet si “ekspozimin aktual, përfshirë me anë të mjeteve të informimit dhe teknologjisë së komunikimit, të një fëmije të përfshirë në sjellje seksualisht eksplicite, qoftë të vërtetë apo të simuluar; ose organeve gjinitale të një fëmije për qëllime kryesisht seksuale” (Kodi Penal, neni 238, paragrafi 5).

⁴² Ibid, neni 238 paragrafi 2.

⁴³ Ibid, Kapitulli XX Veprat Penale kundër Integritetit Seksual.

⁴⁴ Sipas Kodit Penal, “dhunimi” përkufizohet si: “1. I Kushdo që detyron personin tjetër për të kryer akt seksual pa pëlqimin e personit të tillë, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.”. Më tej, “sulmi seksual” përkufizohet si: “Kushdo që prek personin tjetër me qëllim seksual ose e cjt personin e tillë të prekë kryesin apo personin tjetër për qëllim seksual, pa pëlqimin e personit të tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vjet.” “Degradimi i identitetit seksual” përkufizohet si “Kushdo që cjt personin tjetër të ekspozojë pjesët intime të trupit të personit të tillë, të masturbojë ose të kryej ndonjë akt tjetër që degradon integritetin seksual të personit të tillë, pa pëlqimin e personit të tillë, dënohet me gjobë ose me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në një (1) vit.”.

integritetit seksual të një personi, sanksionohen dhe kanë dënime me burgim nga dy deri në pesëmbëdhjetë vjet.⁴⁵

Aktet seksuale pa miratimin e personit përkufizohen si: “penetrim sado i vogël i organit seksual në cilëndo pjesë të trupit të personit ose penetrim sado i vogël në hapjen anale apo gjenitale të personit me ndonjë send ose me cilëndo pjesë tjetër të trupit.”⁴⁶ Në nenin 239 të Kodit Penal, abuzimi seksual nga një person që keqpërdor pozitën, autoritetin apo profesionin e tij apo të saj, ndaj një personi, duke e detyruar atë person të bëjë një akt seksual, duke e prekur atë person për qëllime seksuale, apo duke nxitur një person tjetër të ekspozojë pjesët e trupit dhe duke e denigruar integritetin seksual të personit, përbën rrethanë të abuzimit të pozitës së tij apo të saj. Keqpërdorimi i detyrës mund të bëhet në lidhje me rrethanat financiare, familjare, shoqërore, shëndetësore, të punësimit, arsimore, fetare, apo të tjera, të një personi. Në këto raste, kryerësi do të ndëshkohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Dështimi në raportimin e njohurive apo informatave për përgatitjen apo ekzekutimin e veprës kriminale, ndëshkohet edhe me gjobë dhe burgim deri në tre vite.⁴⁷ Kjo do të thotë se zyrtarët dhe qytetarët e zakonshëm kanë përgjegjësi ligjore që të raportojë çdo informatë që kanë për veprat penale kur këto ndodhin.

Si përfundim, dispozitat e kodit penal ofrojnë mjete mbrojtëse të përparura kundër viktimave të cenueshme, duke përfshirë abuzimin seksual. Megjithatë, ato nuk arrijnë të ofrojnë një përkufizim specifik të ngacmimit seksual *per se*. Kjo ndikon në zbatimin e Kodit Penal dhe mbrojtjen e viktimave nga ngacmimi seksual. Kjo duhet të zgjidhet përmes ndryshimeve legjislative, sikurse shtjelohet në kapitullin “Rekomandime”.

Lidhur me ngacmimin në rrugë, Ligji për Rendin dhe Qetësinë Publike përfshin një klauzolë të paqartë për adresimin e sulmeve verbale: personat të cilët, në vendet publike, fyejnë me fjalë me qëllim provokimin e cenimit të rendit dhe qetësisë publike. Kjo konsiderohet kundravajtje, e cila dënohet me gjobë nga 30 deri në 500 euro, ose burgim deri në 40 ditë.⁴⁸ Megjithatë, RrGGK-ja nuk ka gjetur prova të individëve, të cilët e kanë përdorur këtë ligj apo kanë pasur ankesa për shkelje të tilla në ndonjë gjykatë të themeluar sipas ligjit. RrGGK-ja ka marrë informata që këto raste i janë raportuar policisë, mirëpo këto të fundit nuk janë marrë seriozisht nga policia dhe, rrjedhimisht, nuk janë përcjellë në organet e dhura,⁴⁹ domethënë në gjykatën themelore, divizionin për kundravajtje.

Procedurat për parashtrimin e ankesave për ngacmime

Në Ligjin e Kosovës për Shërbimin Civil, procedurat për parashtrimin e ankesave administrative lidhur me shkeljet e ligjit, janë të përkufizuara më qartë sesa në Ligjin Kundër Diskriminimit, të vitit 2004 dhe Ligjit për Barazinë Gjinore. Ligjet e sapo-miratuara për mbrojtjen nga diskriminimi dhe barazia gjinore kanë bërë disa qartësime të pjesëve të paqarta. Megjithatë, procedura e parashtrimit të ankesave për shkeljet e pretenduara dhe procedura në rast të shkeljes së neneve të tjera të lidhura me barazinë gjinore mbeten të paqarta.

Ligji për Shërbimin Civil mund të përdoret vetëm lidhur me marrëdhëniet në shërbimin civil. Këtu bën pjesë administrata qeveritare e nivelit qendror dhe komunal, si Zyra e Kryeministrit dhe Zyra e Kryetarit të Shtetit, personeli i Kuvendit të Kosovës, agjencitë ekzekutive dhe agjencitë e pavarura dhe rregullatore.⁵⁰ Në raste të shkeljes së këtij ligji, shërbyesit civilë dhe punëdhënësit e tjerë iu nënshtrohen masave disiplinore.⁵¹ Nisja e procedurës penale kundër shërbyesve civilë i pezullon masat disiplinore derisa të ketë një aktgjykim penal të formës së prerë. Pas aktgjykimit, mund të nisin

⁴⁵ Ibid, neni 230, para 4.10; neni 232, paragrafi 3.10; dhe neni 233, paragrafi 3.10.

⁴⁶ Ibid, neni 228, paragrafi 3.

⁴⁷ Ibid, neni 385 dhe 386.

⁴⁸ Ligji i Kosovës për Rendin dhe Qetësinë Publike, nr. 03/L-142, 2009, neni 5, paragrafi 2 marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2009-142-sh.pdf>.

⁴⁹ Takim në tryezë të rrumbullakët, i RrGGK-së me aktivistët e rinj dhe përfaqësuesit e Policisë së Kosovës, dhjetor 2014, Prishtinë.

⁵⁰ Ligji i Kosovës për Shërbimin Civil, neni 1, marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-149-alb.pdf>.

⁵¹ Ibid, neni 51.

procedurat disiplinore.⁵² Për shkeljen e parimeve të diskriminimit dhe barazisë në mundësi, ekzistojnë masa të ndryshme, të garantuara me Ligjin e Kosovës për Shërbimin Civil.⁵³ Për shembull, në rastet kur anëtarë të menaxhmentit të lartë akuzohen për diskriminim, duhet të formohet një komision disiplinor.⁵⁴ Ndërkohë që disa të intervistuar e dinin se ekzistonte mundësia që komisionet të formoheshin, nuk u raportua asnjë rast specifik kur këto komisione ishin ngritur në të vërtetë.⁵⁵ Institucionet e tjera të administratës publike, të rregulluara me ligje të veçanta, iu nënshtrohen dispozitave të Ligjit të Kosovës për Shërbimin Civil, përveç nëse ligji i veçantë përmban dispozita të cilat ndryshojnë nga Ligji i Kosovës për Shërbimin Civil.⁵⁶

Institucionet arsimore dhe shëndetësore iu nënshtrohen dispozitave të ligjeve të veçanta, dhe jo Ligjit të Kosovës për Shërbimin Civil. Për shembull, në Ligjin për Arsimin Para-Universitar shkruhet: “Qasja dhe përparimi nëpër të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimin parauniversitar do të mundësohet në pajtim me dispozitat e këtij ligji pa diskriminim në baza ekzistuese ose të supozuara, siç është ai: gjinor, racor, i orientimit seksual, i paaftësitë fizike.” Më tej, në nenin 4 për “Mbrotja e grupeve të cënueshme”, parashihet: “Të gjithë personat e punësuar në institucione arsimore, të themeluara sipas këtij ligji, do të ndërmarrin të gjithë hapat e arsyeshëm që të sigurojnë se nxënësit dhe punonjësit nuk lëndohen apo u ekspozohen fjalëve dhe veprimeve fyese.”⁵⁷ Edhe pse ky ligj nuk deklaroi se cilat sanksione duhet të përdoren në rast se ndodh kjo, Ligji nr. 2002/2 për Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, parasheh se: “Asnjë person nuk mund të emërohet në një post mësimdhënie në qoftë se, ai është dënuar më parë për një krim dhunë apo veprime të padenja me apo që prekin fëmijët [...] Kur një prej anëtarëve të stafit është nën hetime penale për përdorim dhune ose për veprime të padenja me ose që përfshijnë fëmijët, ai ose ajo duhet që të pezullohet nga puna me pagesë deri në përfundim të hetimeve [sic].”⁵⁸

Lidhur me sistemin e kujdesit shëndetësor, Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Shërbimin e Kujdesit Shëndetësor, neni 6, për “Të drejtën në dinjitetin njerëzor”, parasheh se: “Gjatë trajtimit mjekësor duhet të respektohen: dinjiteti, jeta private, integriteti personal dhe bindjet religjioze të qytetarit”.⁵⁹ Më tej, “Gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore, duhet të respektohet intimiteti i qytetarit dhe mund të kërkohej që rrobet e tij të largohen vetëm për periudhën e kohore dhe në masën, që mund të arsyetohet me shkaqe profesionale.”⁶⁰ Megjithatë, ligji nuk e adreson ngacmimin seksual në mënyrë shprehimore.

Rishikimet e ligjeve të vjetra për barazinë gjinore dhe kundër diskriminimit duhet të kishin adresuar në mënyrë specifike mangësitë e sipërpërmendura, duke përfshirë edhe dispozita lidhur me këto institucione. Megjithatë, të dyja këto ligje të reja kërkojnë që të nxirren udhëzime administrative si akte nën-ligjore. Këto duhet të kujdesen që institucionet arsimore dhe shëndetësore të kenë edhe procedura të qarta për menaxhimin e ngacmimit seksual.

Rregullorja nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, e ndalon ngacmimin seksual në marrëdhëniet e punës në shërbimin civil, duke e përkufizuar atë se tërësi veprimet kundër

⁵² Ibid, neni 63.

⁵³ Sipas Ligjit të Kosovës për Shërbimin Civil, parimi i jo-diskriminimit nënkupton se: “Nuk lejohet kurrfarë diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal” (neni 5, paragrafi 1.2). Ligji përcakton parimin e mundësive të barabarta për komunitetet dhe gjinitë: “mundësi të barabarta për pjesëmarrje në shërbimin civil në institucionet e administratës qendrore dhe komunale. Mundësi të barabarta për pjesëmarrje në shërbimin civil në organet e administratës publike kanë pjesëtarët e dy gjinive” (neni 5, paragrafi 1.9).

⁵⁴ Ligji i Kosovës për Shërbimin Civil, neni 72.

⁵⁵ Intervista të RrGGK-së, 2015.

⁵⁶ Ligji i Kosovës për Shërbimin Civil, neni 1.

⁵⁷ Republika e Kosovës, Ligji për Arsimin Para-Universitar në Republikën e Kosovës, 2011, marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20arsimin%20parauniversitar.pdf>.

⁵⁸ Republika e Kosovës, Ligji nr. 2002/2 mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, 2002, neni 32, marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2428>.

⁵⁹ Republika e Kosovës, Ligji nr. 2004/38, për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor, 2004, paragrafi 6.1, marrë nga: http://msh-ks.org/wp-content/uploads/2013/11/2004_38-Ligji-per-te-drejtat-dhe-pergjegjesite-e-qytetarave-ne-Kujdesin-Shendetesor.pdf.

⁶⁰ Ibid, paragrafi 6.5.

“ndonjë nëpunësi tjetër civil, funksionarit publik ose palës, i përkufizuar si sjellje fizike apo verbale e natyrës seksuale, e cila shkel dinjitetin e femrës ose të mashkullit në punë e që është e padëshirueshme ose fyese për personin.”⁶¹ Rastet e ngacmimit seksual konsiderohen të rënda. Të gjitha institucionet e administratës publike, të cilat punësojnë shërbyes civilë, duhet të krijojnë një komision disiplinor, i cili merr masa disiplinore, duke përfshirë edhe ato për shkak të rasteve të ngacmimit seksual. Procedura e përkufizuar në Rregulloren nr. 04/2011 kërkon që Komisioni Disiplinor të përbëhet nga tre anëtarë nga shërbimi civil, të cilët emërohen nga menaxheri më i lartë administrativ i institucionit, të cilët duhet të kenë njohuri për fushën ku është bërë shkelja, duke përfshirë edhe diversitetin gjinor.⁶² Masat që mund të merren nga Komisioni variojnë nga pezullimi parandalues nga puna deri në tri muaj, shqiptim i hetimeve të pezulluara, pezullim nga ushtrimi i detyrave dhe ndalimi i rrogës deri në dy muaj; largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme, ndërprerja e marrëdhënies së punës dhe pensionimi i hershëm.⁶³ Megjithatë, kjo rregullore nuk parashikon kalimin e barrës së provës, në rastin e ankesave për shkak të ngacmimit seksual, sikurse kërkohet nga Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi. Ligji i Kosovës për Shërbimin Civil gjithashtu parashikon përdorimin e zgjidhjes jashtë-gjyqësore, si një formë e përsheptimit të procedurave për zgjidhjen e konflikteve në rastet që mund të zgjidhen përmes një shqyrtimi të brendshëm administrativ. RrGGK-ja nuk ka mundur të gjejë prova lidhur me atë nëse janë përdorur këto dispozita në praktikën e rasteve të ngacmimit seksual.

Përfundime

Duke mbajtur parasysh sasinë e madhe të dispozitave ligjore (shih tabelën 1), procedurat potenciale ligjore që mund të përdoren në rastet e ngacmimit seksual janë të shumta. Përkufizimet e ndryshme që janë ofruar për ngacmimin seksual, procedurat e keqpërcaktuara për parashtrimin e ankesave për shkak të ngacmimit, si dhe mungesa e qartësisë lidhur me organet përgjegjëse tek të cilat duhet të adresohen këto ankesa, e kanë penguar zbatimin e këtyre ligjeve në Kosovë.⁶⁴ Mospërkufizimi specifik i termit “ngacmim” me dispozita ligjore ka bërë që ankesat për shkak të ngacmimit seksual të jenë pothuaj inekzistene në gjykatat e Kosovës. Në fakt, në vitin 2013, nuk është raportuar dhe/ose regjistruar nga Policia qoftë edhe një rast i vetëm për ngacmim, ndërsa në vitin 2014 janë raportuar vetëm shtatë raste.⁶⁵ RrGGK-ja nuk ka gjetur prova se viktimat e ngacmimit seksual kanë përdorur Ligjin Kundër Diskriminimit, të vitit 2004, apo Ligjin për Barazinë Gjinore, si mjete juridike.⁶⁶ As sanksionet e parashikuara nuk janë shqiptuar.

Në të kaluarën, është rekomanduar që Kosova të hartojë një ligj të ri për ngacmimin seksual.⁶⁷ Megjithatë, RrGGK-ja nuk rekomandon që të krijohet edhe një ligj tjetër, i cili do ta ngatërronte edhe më shumë kornizën ligjore e cila tashmë është e paqartë, e paharmonizuar, dhe e tej-komplikuar. Pjesë e problemit është se ekzistojnë shumë ligje dhe procedura lidhur me ngacmimin seksual. Në vend të kësaj, brenda kuadrit ekzistues ligjore, duhet të bëhet përmirësimi i përkufizimeve dhe mekanizmave për raportim (shihni “Rekomandimet”). Ngacmimi seksual, ashtu siç përkufizohet në të drejtën penale dhe civile, duhet të qartësohet në një vend. Më pas, të gjitha ligjet e tjera duhet të referohen tek ai ligj për përkufizimin, procedurat dhe sanksionet. Ligjet e tjera mund të modifikohet pak për të pasqyruar strukturat institucionale të ndryshme, sipas nevojës.

⁶¹ Rregullorja nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, neni 6, paragrafi 1.20, marrë nga: <https://map.rks-gov.net/getattachment/47831aa8-5e46-45b5-bebc-70751da3ec07/RREGULLORE-NR-04-2011-PER-PROCEDURAT-DISIPLINORE-N.aspx>.

⁶² Rregullorja nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, neni 9.

⁶³ Ibid, neni 8.

⁶⁴ Për prova të mëtejshme, ju lutemi të shihni kapitullin për “Reagimin Institucional”.

⁶⁵ Për më shumë informata lidhur me llojet e kundravajtjeve të regjistruara nga policia, ju lutemi të shihni pjesën “Reagimi Institucional” për policinë.

⁶⁶ Meqenëse versionet e rishikuara të këtyre ligjeve janë miratuar vetëm në mesin e vitit 2015, në këtë hulumtim ka qenë e pamundur të monitorohej zbatimi i tyre.


⁶⁷ QKSGj, 2010.

Tabela I. Përmbledhje e kornizës ligjore të ndërlidhur me ngacmimin seksual

Ligji	Neni	Përkufizimi i ngacmimit seksual (nëse ka)	Institucioni përgjegjës	Sanksionet
Kushtetuta, integrimi i KEDKG në ligjin e Kosovës	Neni 11	“Sjellje e padëshirueshme seksuale siç është kontakti fizik dhe afrimi, vërejtjet me ngjyresa seksuale, shfaqja e pornografisë dhe kërkesave seksuale, qoftë me fjalë apo me veprime” (në KEDKG, Rekomandime të Përgjithshme nr. 19).	Gjykata Themelore	Të paqarta
Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi	Neni 4, para. 1.3	“kur një sjellje e padëshirueshme (që përfshin por, nuk kufizohet në sjellje të natyrës së padëshirueshme seksuale dhe/apo psikologjike, që ka për qëllim apo pasojë shkeljen e dinjitetit të personit dhe krijimin e ambientit frikësues, armiqësor, degradues, nënçmues apo fyes) mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji”	Gjykata Themelore	€400 - €1,350
Kodi Penal i Kosovës	Neni 186, 198	Nuk ka përkufizim për ngacmimin seksual, por vetëm për ngacmimin: “një sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme ose komunikon me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmve apo kafshëve shtëpiake ose kushdo që vë tjetrin nën vëzhgim me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmve apo kafshëve shtëpiake; dhe gjatë këtyre veprimeve vë atë person nën frikë të arsyeshme nga vdekja, lëndimi i rëndë trupor, dëmtimi i rëndë i pasurisë ose nën shqetësim të madh emocional [...] [duke përfshirë] përcjelljen apo qëndrimin në pritje; shfaqjen e vazhdueshme të shtëpia, shkolla, puna apo qendra rekreative; përsëritjen e thirrjeve telefonike; dërgimin apo lënien e porositve; dërgimin e mesazheve telefonike, letrave postare apo postës elektronike; ose lënien apo dërgimin e dhuratave të padëshiruara apo të gjësendeve tjera.”	Gjykata Themelore	Dënim me burg ≤3 vite ose me gjobë; nga partneri në familje; 6 muaj deri në 5 vite burgim; nga zyrtarët, ≤3 vite burgim; në rast dhunimi të fëmijës, 6 muaj deri 5 vjet burgim
Ligji i Kosovës për Barazinë Gjinore	Neni 3	“çfarëdo forme të sjelljes së padëshiruar verbale, jo verbale, apo fizike me natyrë seksuale, me qëllim apo pasojë preken apo shkeljen e dinjitetit të një personi, dhe për të krijuar një mjedis frikësues, armiqësor, degradues, poshtërues apo fyes.”	Gjykata Themelore	Gjobë: €300 - €900
Ligji i Kosovës për Shërbimin Civil	Neni 5, para. 1.2, 1.9	“Nuk lejohet kurrfarë diskriminimi [...] në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë [...] orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal” dhe “Mundësi të barabarta për pjesëmarrje në shërbimin civil në organet e administratës publike kanë pjesëtarët e dy gjinive.”	Gjykata Themelore, Departamenti për Kundravajtjet	Nuk janë përmendur sanksionet; Mund të zbatohet Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi
Ligji i Punës i Kosovës	Neni 5.5, 9.2	Ndalon diskriminimin në raport me punësimin dhe ushtrimin e profesionit kur fjala është për rekrutimin, trajnimin, ngritjen në detyrë, termat dhe kushtet e punësimit, duke përfshirë masat disiplinore, marrëdhëniet kontraktuale dhe marrëdhëniet e punës.	Sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Gjykata Themelore	Gjobë €100 to €10,000
Ligji për Rëndin dhe Qetësinë Publike	Neni 5	Nuk e përkufizon ngacmimin seksual, por e konsideron si kundravajtje kur dikush: në vend publik përdor fjalë ofenduese, me qëllim që të provokoj prishjen e rendit dhe qetësisë publike	Gjykata Themelore, Departamenti për Kundravajtjet	Gjobë: €30 to €500; Burgim: ≤ 40 ditë në rast se nuk paguhet gjoba

PERCEPTIMET PËR NGACMIMIN SEKSUAL

Në këtë kapitull shqyrtohen perceptimet dhe pikëpamjet e njerëzve lidhur me ngacmimin seksual, duke u mbështetur në anketimin e kryer në mbarë Kosovën. Të pyetur lidhur me atë se çfarë nënkupton ngacmimi seksual për ta, pjesa më e madhe e respondentëve (69.3%) konsiderojnë veprat kriminale të dhunshme, si përdhunimi apo përdhunimi i mbetur në tentative, format këto të ngacmimit seksual (shihni grafikun I).



Më pak sesa gjysma e kosovarëve mendojnë se favorizmi në këmbim të përfitimeve seksuale (49%); prekja, pickimi apo shtyrja (49%); apo fishkëllimi i njerëzve në rrugë (43.8%) janë forma të ngacmimit seksual. Rreth një e treta e respondentëve i konsiderojnë aktet e mëposhtme si forma të ngacmimit seksual: mbështetjen për trupin e personit pa lejen e tij/saj; shikimet dhe gjestet seksuale pa dëshirën e personit; dërgimin e letrave, thirrjet telefonike pa dashjen e personit; presion për të dalë së bashku (për kafe, drekë, darkë); pyetjet, vërejtjet, apo shakatë seksuale pa dashjen e personit; referimin e personave me fjalë si: “zemër”, “syn”, “llokum”. Fare pak persona e konsiderojnë postimin e fotografive në internet pa lejen e personit (15.6%) apo favorizmin në këmbim të përfitimeve seksuale (16.8%) (p.sh. marrja e notave më të mira në arsim, ngritje në detyrë, apo rritje page) si forma të ngacmimit seksual.

“Të përcjellurit dhe të fishkëlluarit nuk është ngacmim seksual”

- Grua, moshë 57, Kamenicë

“Gratë nuk mendojnë se është ngacmim seksual kur vjen nga bashkëshorti i tyre.”

- Përfaqësues, Qendra e Shëndetit Mendor

një personi tjetër”, “dhe mosrespektimi i vajzave/grave nga meshkujt/burrat”. Të tjerë thoshin se ngacmimi seksual është “imoral” ose “diçka e keqe”. Të paktë ishin respondentët që e interpretonin ngacmimin seksual si në fjalë të llojit “kur bashkëshorti dëshiron të bëjë seks, por unë nuk dua”, apo “kur babai ngacmon vajzën e vet”.

Sikurse lihet të kuptohet nga grafiku 1, duket se ekziston një marrëdhënie domethënëse midis gjinisë dhe perceptimeve të asaj se çka përbën ngacmim seksual. Në përgjithësi, një përqindje më e lartë e burrave sesa ajo e grave ka prirjen të identifikojë format e ngacmimit seksual si të tilla.⁶⁸ RrGGK-ja ka gjetur se respondentët e moshës 56-64 vjeçare kanë më shumë të ngjarë t'i konsiderojnë këto akte si forma të ngacmimit seksual: dërgimi i letrave apo bërja e thirrjeve telefonike pa dashjen e personit; bërja e pyetjeve apo shakave seksuale pa dashjen e personit; fishkëllimat në rrugë; dhe postimin e fotove pa dashjen e personit.⁶⁹ Personat mbi 56 vjeç kanë më shumë të ngjarë sesa grup-moshat e tjera që ta konsiderojnë presionin për të dalë së bashku (p.sh. për kafe, drekë apo darkë) dhe referimin e personave me fjalë si loqë, zemër, syn, llokum, si ngacmim seksual.⁷⁰ Pra, me një fjalë, personat më të mëdhenj në moshë kanë më shumë të ngjarë sesa personat më të rinj që të identifikojnë më shumë forma të ngacmimit si të tilla.


Kosovarët kanë prirjen të pranojnë se “një mësimdhënës/e që i kërkon nxënësit/ses të shkojë natën vonë në zyrë, i vetëm/e vetme, për të marrë notën” është një formë e ngacmimit seksual (85.7%), edhe pse një përqindje pak më e madhe e grave (88.9%) e konsiderojnë këtë si ngacmim seksual sesa ajo e burrave (82.5%). Sikurse ilustron grafiku 2, pak më shumë gra (83%) sesa burra (75.1%) e konsiderojnë bërjen e komenteve për personat në rrugë apo postimin e fotove seksuale të një personi tjetër në internet si forma të ngacmimit seksual (85.9% gra dhe 79.8% burra).

⁶⁸ RrGGK-ja ka kryer një test të “Chi-square”, i cili, me një nivel konfidence prej 95% ka treguar se burrat kanë më shumë të ngjarë sesa gratë që t'i konsiderojnë këto veprime si ngacmim seksual: presionin e dhunshëm për shërbime seksuale; prekjen, pickimin, dhe goditjen me grusht; mbështetjen mbi trupin e dikujt tjetër pa lejen e tij/saj; shikimin apo bërjen e gjesteve seksuale kundër vullnetit të një personi; dërgimin e letrave; bërjen e telefonatave pa lejen e personit; nxitjen e personit për të dalë (p.sh. për darkë, drejtë, për të pirë një kafe, etj.); postimin e fotografive në internet pa lejen e personit. Testi “chi-square”, me një nivel konfidence prej 95%, ka treguar se nga të gjitha format e ngacmimit seksual, gratë kanë më shumë të ngjarë sesa burrat ta konsiderojnë favoritizmin në shkëmbim të shërbimeve seksuale si formë të ngacmimit seksual. Nuk ka asnjë diferencë statistike domethënëse midis burrave dhe grave kur është fjala për përcaktimin e këtyre veprimeve si forma të ngacmimit seksual: dhunimi apo përdhunimi në tentativë, pyetjet apo shakatë seksuale kundër vullnetit të personit, referimi i personit me fjalë si “loqë”, “zemër”, “syn”, “llokum”, etj., dhe fishkëllimin në rrugë.

⁶⁹ Testi “Chi-square” me nivel konfidence prej 95%.

⁷⁰ Testi “Chi-square” me nivel konfidence prej 95%. Nuk ekziston ndonjë dallim statistike domethënës midis kategorive moshore për format e tjera të ngacmimit seksual.


Grafiku 2. Perceptimet se çka përfshin ngacmimi seksual



Perceptimet lidhur me ngacmimin seksual në vendin e punës


Pjesa më e madhe e kosovarëve e dinë se eprorët nuk janë të *vetmit* persona që mund të përfshihen në ngacmimin seksual në vendin e punës (69.7%). Pjesa më e madhe mendon se ngacmim seksual është kur shefi e bën punëtorin/ren të dalë për darkë për qëllim të mbarimit të punëve jashtë zyrës (79.6%). Sikurse tregohet në grafikun 3, një numër pak më i ulët i burrave (71.7%) sesa i grave (81.2%) besojnë se ngacmimi seksual është kur kolegu/ia bën komente të natyrës seksuale për kolegen/un; kur shefi e bën punëtorin/ren të dalë së bashku për darkë me qëllim të mbarimit të punëve jashtë zyrës (76.4% e burrave); apo kur shefi e prek punëtorin/ren në mënyrën në të cilën ai/ajo nuk ka dëshirë të preket (87.3% e burrave).

Grafiku 3. Opinione e kosovarëve mbi ngacmimin seksual në Punë



Perceptimet në lidhje me atë se kush mund të kryejë ngacmim seksual

Sikurse ilustruhet në grafikun 4, pjesa më e madhe e kosovarëve bien dakord që ngacmim seksual ka kur një burrë ngacmon një grua (91.1%) dhe që edhe gratë mund të ngacmojnë burrat (84.6%). Një numër pak më i vogël i njerëzve besojë se një grua mund ta ngacmojë seksualisht një grua tjetër (75.7%) apo se një burrë e ngacmon seksualisht një burrë tjetër (77.8%). Kjo lë të kuptohet se disa kosovarë nuk janë të vetëdijesuar se ngacmimi seksual mund të ndodhë midis personave homoseksualë. Ndërkohë që gratë dhe burrat kanë prirjen të kenë perceptime të ngjashme, gratë kanë më shumë të ngjarë sesa burrat që të mendojnë se ngacmimi seksual mund të përfshijë edhe rastin kur një grua ngacmon një grua tjetër.⁷¹



Sipas njerëzve, pse ndodh ngacmimi seksual?

Pothuaj një e treta e kosovarëve (31.1%) besojë se njerëzit natyrshëm i ngacmojnë seksualisht të tjerët kur kanë tërheqje ndaj tyre dhe kjo sjellje është “në rregull”. 15.1% nuk e dinë nëse kjo sjellje është “në rregull” apo jo. Më shumë burra (35.4%) sesa gra (26.9%) kanë prirjen të bien dakord se kjo sjellje është në rregull.⁷² Si tek burrat, ashtu edhe tek gratë, ekziston një besim disi i përhapur që “vajzave të reja iu pëlqen të ngacmohen seksualisht” (40.5%). Më tej, rreth 74% e kosovarëve besojnë se “gratë i sjellin vetes probleme me ngacmim seksual duke u veshur apo duke u sjellë në mënyrë provokative” (grafiku 5). Pak më shumë gra (77.6%) janë dakord me këtë pohim sesa burrat (70.3%).⁷³ Vetëm 16.3% e kosovarëve nuk janë dakord me këtë pohim, ndërkohë që 9.5% të tyre nuk e dinë.

“Po të mos përdridhet qenushja, as qenët nuk i shkojnë pas.”


- Grua, 65 vjeçe, Glogoc, duke folur për veshjen provokative të grave

⁷¹ Statistikisht domethënëse, duke përdorur testin “chi-square” me nivel konfidence prej 95%.

⁷² Testi “chi-square” dhe bashkëshoqërimi me nivel konfidence prej 95% tregojnë se burrat kanë më shumë të ngjarë sesa gratë që të bien dakord me këtë pohim.

⁷³ Testi “chi-square” lë të kuptohet se ekziston një marrëdhënie statistikisht domethënëse. Megjithatë, kjo është pranë limitit (0.045) dhe bashkëshoqërimi është statistikisht jodomethënës për shkak të rrumbullakosjes (0.045 në limitin 0,05).

Grafiku 5. Perceptimet se përse ndodh ngacmimi seksual



Gjetjet e anketimit lënë të kuptohet se kultura e “fajësimit të viktimës” është disi e mirë-përhapur në Kosovë. “Fajësimi i viktimës” ndodh kur personi që ka qenë viktimë i një krimi akuzohet pjesërisht apo plotësisht për krimin e kryer.⁷⁴ Shembull klasik janë gratë të cilat tradicionalisht akuzohen se gjoja janë viktimë të abuzimit seksual për shkak të veshjes që kanë pasur kur ka ndodhur krimi; sepse “po e kërkonin”;⁷⁵ sepse e kishin humbur virgjërinë; apo sepse u kishte “dalë nami” që dilnin me burra. Pavarësisht këtyre perceptimeve, ngacmimi apo abuzimi seksual nuk mund t’i atribuohet veshjeve apo veprimeve të viktimës. As nuk mund të justifikohet për ndonjë shkak tjetër. Ngacmimi seksual është i paligjshëm dhe i pajustificueshëm. Krimi mbetet krim dhe veshja apo sjellja e viktimës nuk duhet të konsiderohen të rëndësishme në procedurat para gjykatave. Në fakt, fajësimi i viktimës mund të identifikohet si formë e “viktimizimit të dytë” të viktimës.⁷⁶

Më konkretisht, shkaqet reale të ngacmimit seksual mund t’i atribuohen marrëdhënieve të pushtetit, sidomos midis grave dhe burrave, sipas të cilave burrat kanë prirjen të posedojnë më shumë pushtet social në kontekstet socio-kulturore, duke përfshirë Kosovën e sotme. Në Deklaratën për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së ka pranuar se:

Dhuna ndaj grave është manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave, të cilat kanë çuar në dominimin e grave dhe diskriminimin e tyre nga ana e burrave dhe në pengimin e zhvillimit të plotë të grave. [...] Dhuna ndaj grave është formë e shkeljes së të drejtave të njeriut, dhe një prej mekanizmave vendimtarë shoqërorë përmes të cilave gratë detyrohen të qëndrojnë në pozicione të nënshtuara në raport me burrat. Dhuna kundër grave përbën një pengesë për arritjen e barazisë, zhvillimit dhe paqes.⁷⁷

Për këtë arsye, adresimi i shkaqeve burimore të ngacmimit seksual dhe formave të tjera të dhunës seksuale përfshin minimin e marrëdhënieve ekzistuese të pushtetit midis grave dhe burrave. Këtu bën pjesë zgjidhja e perceptimeve të gabuara dhe justifikimeve për ndodhjen e dhunës seksuale, siç është fajësimi i viktimës.

⁷⁴ Ky term u përdor për herë të parë nga William Ryan-i në librin e tij të titulluar Fajësimi i Viktimës (1971), ku ai argumentonte se kjo ishte ideologjia që përdorej për të justifikuar krimet e kryera ndaj njerëzve me ngjyrë në Shtetet e Bashkuara. Që prej asaj kohe, ky term është përdorur për të diskutuar dhunën seksuale, duke përfshirë edhe dhunën në familje. Për më shumë shpjegime dhe shembuj, shihni artikullin me titull “Fajësimi i Viktimës” (Victim Blaming) në Wikipedia (https://en.wikipedia.org/wiki/Victim_blaming, parë për herë të fundit më 24 janar 2016).

⁷⁵ Nicky Ali Jackson, *Enciklopedia e Dhunës në Familje*, Taylor & Francis, 2007, fq. 715.

⁷⁶ Campbell, R. dhe Raja, S., “Viktimizimi i dytë i viktimave të përdhunimit; njohuri nga profesionistët e shëndetit mendor, që i trajtojnë të mbijetuarit e dhunës,” *Violence and Victims* [Dhuna dhe Viktimat], 14 (3), 1999, fq. 261–275.

⁷⁷ Rezoluta 48/104 e Kombeve të Bashkuara, e datës 20 dhjetor 1993.

Përfundime

Pjesa më e madhe e të anketuarve i konsiderojnë veprat penale, siç janë dhunimi apo përdhunimi i mbetur në tentativë, si forma të ngacmimit seksual. më pak se gjyma e të anketuarve mendojnë se presioni për shërbime seksuale, prekja, pickimi, shtyrja, apo fishkëllimi në rrugë drejtuar dikujt përbëjnë forma të ngacmimit seksual. Një përqindje më e lartë e burrave sesa e grave, priren të identifikojnë pjesën më të madhe të formave të ngacmimit seksual si të tilla. Disa kosovarë nuk janë të informuar se ngacmimi seksual mund të ndodhë brenda personave homoseksualë. Afërsisht një e treta e kosovarëve, më shumë burra sesa gra, besojnë se njerëzit i ngacmojnë të tjetër natyrshëm kur ndihen të tërhequr prej tyre dhe kjo sjellje është “në rregull”. Ajo çka është alarmuese është se kultura e “fajësimit të viktimës” në rastet kur ndodh ngacmimi seksual, është e përhapur kudo, ku rreth 74% e kosovarëve besojnë se “gratë i sjellin vetes problemet me ngacmim seksual duke u veshur apo duke u sjellë në mënyrë provokative.” Pak më i lartë është numri i grave të cilat bien dakord me këtë pohim, në krahasim me numrin e burrave. Kjo pjesë lë ë kuptohet se sensibilizimi lidhur me format e ndryshme të ngacmimit seksual, personat që kryejnë ngacmim seksual, dhe arsyet se pse ndodh ngacmimi (p.sh. jo sepse gratë “e kërkojnë vetë”), do të jenë vendimtare për të adresuar ngacmimin seksual në Kosovë në të ardhmen.

PËRHAPJA E NGACIMIT SEKSUAL

Në këtë pjesë trajtohet përhapja e ngacimit seksual në Kosovë, duke u mbështetur në përvojat që kanë raportuar respondentët gjatë intervistimit, lidhur me ngacimin seksual. Duke marrë parasysh mungesën e qartësisë në kornizën ligjore lidhur me atë se çka mund të përfshijë ngacimi seksual, si dhe mungesën e njohurive të disa respondentëve lidhur me ngacimin seksual, RrGGK-ja ka pyetur lidhur me aktet e ndryshme të cilat kanë mundur të ndodhin, në vend që të përdorte termin më të përgjithshëm “ngacim seksual”.

Prevalenca gjatë jetës


Llogaritet se 48.5% e kosovarëve kanë përjetuar ndonjë formë të ngacimit seksual gjatë jetës së tyre. Gratë kanë konsiderueshëm më shumë të ngjarë të përjetojnë ngacim seksual sesa burrat.⁷⁸ Ndërkohë që rreth 64.1% e grave raportojë se kanë përjetuar ngacim seksual, 32.5% është pjesa e burrave që kanë përjetuar ngacim seksual.⁷⁹ Individët e moshës 18-25 vjeç kanë më shumë të ngjarë të raportojnë se kanë përjetuar ngacim seksual, ndërsa personat e moshës 46 vjeçare e sipër kanë më pak të ngjarë të raportojnë të njëjtën gjë. Shifrat në mesin e grup-moshave më të reja mund të jenë më të larta sepse ata kanë më shumë të ngjarë ta raportojë atë apo t'u kujtohet që e kanë përjetuar, ndërsa grup-moshat më të mëdha mund të hezitojnë ta raportojë ose mund të mos u kujtohen përvoja të tilla.⁸⁰ Midis përjetimit të ngacimit seksual dhe etnicitetit apo, përkatësisht, banimit në një zonë rurale apo urbane, nuk është gjetur ndonjë bashkëshoqërim (korelim) domethënës.

Forma më e zakonshme e ngacimit seksual e raportuar nga respondentët është kur dikush ka bërë komente, shaka, apo gjepte të padëshiruara seksuale, me ta apo lidhur me ta, duke përfshirë edhe gjatë kohës së ecjes në rrugë (grafiku 6). Rreth një e treta e kosovarëve (31.6%) kanë thënë se kjo u ka ndodhur atyre. Një përqindje thelbësisht më e madhe e grave (47.4%) sesa ajo e burrave (15.4%) e kanë përjetuar këtë ngacim.

⁷⁸ Si testi “chi-square” me një nivel konfidence prej 95%, ashtu edhe analiza e bashkëshoqërimit me një nivel sinjifikance prej 95%, tregojnë një marrëdhënie domethënëse.

⁷⁹ RrGGK-ja ka gjetur një bashkëshoqërim statistikisht domethënës në nivelin e konfidencës prej 95% me gjininë dhe moshën. Nuk duket se ekziston ndonjë marrëdhënie statistikisht domethënëse midis grup-moshave 26-35 vjeçare dhe 36-45 vjeçare dhe përvojës së ngacimit seksual.

⁸⁰ Kësaj mund t'i referohemi edhe si “problem i kujtesës” në fushën e kërkimit në shkencat sociale, ku ngjarja ka ndodhur shumë kohë më parë që respondentët ta kujtojnë. Problemet e kujtesës kanë më shumë të ngjarë të prekin njerëzit me moshë më të madhe sesa njerëzit me moshë më të vogël, përse i takon kësaj linje pyetjesh.



Pavarësisht sigurive të konfidencialitetit, pak njerëz raportuan dhunë seksuale. Kjo nuk është e vërtetë vetëm në Kosovë, por në të gjithë botën.⁸¹ Fakti se nuk raportohet në polici apo në sondazhet sociale nuk nënkupton se dhuna seksuale nuk ekziston. Njerëzit thjesht mund t'i druhen raportimit ose mund ta konsiderojnë çështje personale, edhe në rastet kur ajo përbën vepër penale. Vetëm 2.2% e të anketuarve u shprehën se ishin detyruar të bënin diçka seksuale të cilën ata nuk donin ta bënin në një moment të jetës së tyre (1.7% e burrave dhe 2.7% e grave).⁸²

⁸¹ Për shembull, në Shtetet e Bashkuara është vlerësuar se 68% e sulmeve seksuale në një periudhë prej pesë vitesh nuk ishin raportuar (Rape Abuse Incest National Network (RAINN), Reporting Rates [Normat e Raportimit], marrë nga: <https://rainn.org/get-information/statistics/reporting-rates>). Në BE, "mesatarisht 6% e grave kanë treguar se kanë përjetuar dhunë seksuale nga një person i cili nuk është partneri aktual apo i mëparshëm, mesatare e cila varion nga 1% në Greqi dhe Portugali në 12% në Holandë dhe Suedi [...] në BE të paktën 11 milionë gra kanë përjetuar dhunë seksuale nga një jo-partner, që prej moshës 15 vjeçare" (Instituti Evropian për Barazi Gjinore, Indeksi i barazisë gjinore 2015: Matja e barazisë gjinore në Bashkimin Evropian 2005-2012, 2015, marrë nga: <http://eige.europa.eu/sites/default/files/documents/mh0215616enn.pdf>). Nëse ka një numër më të lartë të personave të cilët raportojnë se përjetojnë dhunë seksuale, kjo mund të nënkuptojë se ka një incidencë më të lartë. Megjithatë, një interpretim tjetër është se njerëzit (për shembull, në Holandë apo Suedi), kanë më shumë të ngjarë që të jenë të sensibilizuar dhe nga pikëpamja kulturore janë më të gatshëm për ta raportuar dhunën seksuale, në krahasim me njerëzit e tjerë (për shembull, në Portugali apo Greqi).

⁸² Për shembull, një respondente tha se ishte mashtruar dhe më pas abuzuar seksualisht, nën kërcënimin e armës, në Prishtinë (mosha 40 vjeçare, Gillogoc, anketim i RrGGK-së, 2015). Më vonë ajo vuajti edhe nga dhuna që ushtronte mbi të bashkëshorti

Një përqindje pak më e lartë e respondentëve (2.4%) kanë thënë se ndonjë mësimdhënës i ka prekur në një mënyrë seksuale (3% gra dhe 1.9% burra). Disa gra (9%) dhe burra (9.6%) kanë raportuar se janë prekur në një mënyrë seksuale, të padëshiruara. Rreth 7.7% e kosovarëve kanë thënë se u janë treguar foto seksuale të cilat nuk donin t'i shihnin, ndërkohë që 7% kishin parë dikë të shfaqte apo ekspozonte veten. Një përqindje pak më e lartë e burrave (8.7%) sesa ajo e grave (5.3%) kanë raportuar se të tjerët iu janë ekspozuar atyre. Ky ka qenë rasti i vetëm i identifikuar në të cilin burrat kishin statistikisht më shumë të ngjarë sesa gratë që të përjetonin dhunë seksuale.

Megjithëse ngacmimi seksual përmes internetit përbën një dukuri disi më të re, dy për qind e kosovarëve raportojë se dikush ka postuar fotografi zbuluese të tyre në internet dhe 11.9% kishin pasur dikë i cili kishte bërë komente apo shaka seksuale të padëshiruara lidhur me ta në internet. Personat e moshës nga 18 në 25 vjeçare kishin statistikisht më shumë të ngjarë të përjetonin dhunë seksuale në internet sesa personat që bëjnë pjesë në grup-moshat më të rritura.⁸³

Thënë përmbledhtazi, 3.4% e kosovarëve kanë thënë se të tjerët i kanë quajtur gej apo lesbike në një mënyrë negative në një moment të jetës së tyre. Përfaqësues të grupeve që mbështesin personat lezbike, gej, biseksualë, transgjorë apo queer (LGBTQ) në Kosovë kanë thënë se ngacmimi seksual është i zakonshëm. Krahas ngacmimit seksual të personave LGBTQ midis njëri-tjetrit, përfaqësuesit e LGBTQ kanë dhënë hollësi edhe për ngacmime nga njerëz të tjerë, duke përfshirë përfaqësues të institucioneve qeveritare. Një përfaqësues i LGBTQ-së u shpreh: "Një nëpunës civil më quajti "peder" në Komunën e Prishtinës. Ai tha: "Na keni lodh me këto organizimet për pederat." ⁸⁴ Për këtë rast është parashtruar një ankesë, e cila është trajtuar nga drejtori i asaj drejtorie. Megjithatë, ky rast ishte në proces e sipër gjatë kohës kur RrGGK-ja kryente hulumtimin e saj.⁸⁵

RrGGK-ja ka marrë raporte edhe për ngacmime seksuale të përjetuara nga persona me aftësi të kufizuara.⁸⁶ Një respondente nga një shoqatë që mbështet personat me aftësi të kufizuara tha se në shoqatën e saj ishin raportuar 22 raste të ngacmimit seksual ndaj grave me aftësi të kufizuara.⁸⁷ "Ta them sinjerisht, gratë me aftësi të kufizuara trajtohen si banjë publike," tha ajo. "Kudo që shkojnë për të kryer një punë, u kërkojnë të bëjnë diçka," pretendoi repondentja. Janë raportuar edhe akuza për keqpërdorim të autoritetit, duke përfshirë edhe raste brenda disa organizatave, qëllimi i të cilave është t'u shërbejnë personave me aftësi të kufizuara.⁸⁸ Për shembull, persona që janë në pozicione autoriteti dhe që kërkojnë shërbime seksuale në këmbim të ndihmës dhe asistencës për personat me aftësi të kufizuara. Shkalla në të cilën këto pretendime janë adresuar nga këto organizata është e paqartë.

Në radhët e grave që kanë përjetuar ngacmim seksual në jetën e tyre në Kosovë, 30.4% janë shprehur se ka ndodhur "kur ishin më të reja". Vetëm 9.9% e burrave që kishin përjetuar dhunë seksuale thanë se u kishte ndodhur kur ishin më të rinj në moshë.⁸⁹ Kjo gjetje, e parë së bashku me marrëdhëniet e cekura më lartë, të identifikuara midis përjetimit të ngacmimit seksual, gjinisë dhe rinisë, lënë të kuptohet se të reja mund të jenë mes atyre që janë më së shumti të rrezikuara nga pjesa më e madhe e formave të ngacmimit seksual.

i saj. Në një rast tjetër, një djalë 20-vjeçar tha se kishte kujtime të këqija të dy burrave të cilët e ngacmonin dhe "e preknin", përafërsisht dy vite më parë (mosha 20 vjeçare, Prishtinë, anketim i RrGGK-së, 2015).

⁸³ Ekziston një bashkëshoqërim pozitiv statistikisht domethënëse midis grup-moshës dhe ngacmimit në internet, me një sinjifikancë prej 95%. Ekziston një bashkëshoqërim negativ midis këtyre formave të ngacmimit dhe personave të grup-moshë 56-64 vjeçare dhe personave mbi 65 vjeç. Për të gjitha grup-moshat e tjera, kjo marrëdhënie është e pakonsiderueshme.

⁸⁴ Intervistë e RrGGK-së me përfaqësues të organizatave të LGBTQ, qershor 2015.

⁸⁵ Ibid.

⁸⁶ Intervista dhe bashkëbisedime të RrGGK-së me aktivistë, 2015.

⁸⁷ Intervistë e RrGGK-së me përfaqësues të një organizate që ndihmon personat me aftësi të kufizuara, 2015. Nuk ka informata të disponueshme lidhur me ngacmimin seksual ndaj burrave me aftësi të kufizuara.

⁸⁸ Intervista dhe bashkëbisedime të RrGGK-së me aktivistë që punojnë në këto shoqata.

⁸⁹ Në mënyrë të njëjtë, në BE, gratë e reja kanë më shumë rrezik të ngacmohen seksualisht, në veçanti përmes postës elektronike apo dërgimit të mesazheve tekst (Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejta Themelore (FRA), *Dhuna kundër grave: një studim i mbarë BE-së: Rezultatet në një shikim*, Luksemburg: FRA, 2014, në:

http://fra.europa.eu/sites/default/files/fra-2014-vaw-survey-at-a-glance_en_0.pdf, fq. 12). Komisioni Evropian ka gjetur se gratë e reja, beqare apo të divorcuara kanë më shumë të ngjarë të përjetojnë ngacmim në vendin e punës (Komisioni Evropian, *Ngacmimi seksual në vendin e punës në Bashkimin Evropian*, EC 1998, marrë nga: <http://www.un.org/womenwatch/osagi/pdf/shworkpl.pdf>).

Prevalenca në vitin 2014

Në përgjithësi, 45.2% e kosovarëve kanë përjetuar ndonjë formë të ngacmimit seksual në vitin 2014. Sërish, gratë kishin statistikisht më shumë të ngjarë sesa burrat që të kishin përjetuar ngacmim seksual në vitin 2014. 63% e grave ka raportuar se ka përjetuar ngacmim seksual, krahasuar me vetëm 24.3% të burrave.⁹⁰ Individët e moshave 18-25 vjeç kishin më shumë të ngjarë të kishin përjetuar ngacmim seksual në vitin 2014, ndërsa personat me moshë 46 vjeçare e sipër, kishin më pak të ngjarë.⁹¹

Forma më të dhunshme të ngacmimit që do të mund të konsideroheshin krime sipas ligjeve të Kosovës kanë qenë më pak prevalente ose më pak të raportuara nga ana e respondentëve: 4.8% e grave dhe 3.7% e burrave kanë thënë se në vitin 2014 kanë pësuar sulm seksual. Pak më shumë prej tyre thanë se dikush i kishte shtrënguar apo preku (4.8% gra dhe 3.7% burra).

Ngacmimi seksual duket se është shumë më tepër prevalent për gratë (shihni grafikun 7). Në vitin, 2014, për një në tre gra (34.2%) krahasuar me vetëm 1.6% të burrave, të tjerët i kanë rënë borisë së automjetit ndërkohë që ato kanë qenë duke ecur në rrugë. Më tej, 46.4% e grave dhe vetëm 3.9% e burrave, të tjerët u kanë fishkëllyer; 26.4% e grave dhe 3.3% e burrave janë ndjekur nga dikush; 20.1% e grave dhe 4.7% të burrave ua kanë bllokuar rrugën; dhe 46.5% e grave, krahasuar me vetëm 4.2% të burrave, kanë marrë komente të padëshiruara në rrugë. Krahas kësaj, 11.3% e grave dhe 3.1% e burrave thanë se dikush ka bërë komente eksplicite seksuale për ta.⁹²

“Isha në klasë të tretë mur mua dhe dy shoqe të mia na ndodhën disa djem më të mëdhenj. Ne arritëm të shpëtonim, mirëpo edhe kur e kujtoj e përjetoj traumën dhe ende më shqetëson si problem.”


- Grua, 23 vjeçe, Prishtinë

⁹⁰ RrGGK-ja ka përdorur një test të “chi-square” dhe një analizë të bashkëshoqërimit me nivel konfidence prej 95%, të cilët treguan se ekziston një bashkëshoqërim domethënës midis gjinisë dhe përjetimit të ngacmimit seksual në vitin 2014.

⁹¹ RrGGK-ja ka gjetur një bashkëshoqërim statistikisht domethënës me një nivel konfidence prej 95%, midis gjinisë dhe moshës. Nuk duket se ekziston ndonjë marrëdhënie statistikisht domethënëse midis përjetimit të ngacmimit seksual, në vitin 2014, dhe grupmoshave 26-35 dhe 36-45 vjeçare, jetesën në vende rurale apo urbane, apo me persona të ndonjë përkatësie etnike të caktuar.


⁹² Në një rast, një burrë kujtoi se një grua i ishte afëruar dhe i kishte ofruar shërbime si prostitutë, gjë të cilën ai e kishte konsideruar si formë të ngacmimit (burrë, 19 vjeç, anketim i RrGGK-së, 2015).

Grafiku 7. Përqindja e grave dhe e burrave që kanë përjetuar ngacmim seksual në vitin 2014





Në vitin 2014, 182 njerëz kanë raportuar se dikush kishte bërë komente, shaka, apo gjeste seksuale të padëshiruara drejtpërdrejt atyre apo rreth tyre, në rrugë; 111 kanë thënë se dikush kishte bërë komente apo shaka të padëshiruara seksuale lidhur me ta në rrugë; 45 respondentëve u ishin treguar fotografi seksuale të cilat ata nuk donin t'i shihnin; dhe 36 prej tyre ishin prekur në një mënyrë seksuale të padëshiruar (grafiku 8).

Graph 8. Numri i grave dhe burrave që kanë përjetuar ngacmim seksual në vitin 2014 sipas llojit të ngacmimit



Disa respondentë raportuar se kishin përjetuar ngacmim disa herë gjatë vitit 2014, sikurse ilustrojnë grafikët 9 dhe 10.




Personat që shkaktuar ngacmim seksual ndaj respondentëve?

Nga 561 persona që raportnin se ishin ngacmuar seksualisht në vitin 2014, ata kryesisht ishin ngacmuar nga persona të panjohur në rrugë (421 respondentë). Sikurse ilustron në grafikun 11, respondentët kanë raportuar edhe se janë ngacmuar nga të njohur (77 respondentë), shokë (51), kolegë pune (20), mësimdhënës (12), shefi në punë (7), dhe partnerët e respondentëve (2). Rezultatet tregojnë se gratë kanë prirje të ngacmohen më shumë nga persona të panjohur në rrugë dhe shokë sesa burrat. Burrat kanë më shumë të ngjarë të ngacmohen nga shokët sesa nga gratë.⁹³

“Më ngacmoi kolegja e punës, por nuk e bëra të madhe.”

- Burrë, 22 vjeç,

⁹³ RrGGK-ja bëri testin “chi-square” dhe një analizë të bashkëshoqërimit, të cilat tregojnë një marrëdhënie statistikisht domethënëse (me një nivel konfidence prej 95%). Për të gjithë personat të cilët pretendohet se kanë kryer ngacmim (p.sh. të njohurit, kolegët e punës, mësimdhënësit, shefat, partnerët), nuk ka asnjë marrëdhënie statistikisht domethënëse midis ngacmimit seksual dhe gjinisë.



Ngacmimi seksual në punë

Një raport i publikuar nga Komisioni Evropian për ngacmimin seksual në vendin e punës ka gjetur se rreth tri nga katër gra “që veprojnë nën cilësi si profesionist apo kanë pozita pune në krye të menaxhmentit” kanë vuajtur nga ngacmimi seksual gjatë qëndrimit në vendin e punës.⁹⁴ Më tej, “një në katër prej këtyre grave janë përballur me ngacmimin seksual në 12 mujorin para anketimit [...]”. Të rejat, gratë me nivel më të ulët arsimor dhe punonjëset e përkohshme mund të jenë të rrezikuara nga ngacmimi.⁹⁵ Burrat kanë prirje të përbëjnë pjesën kryesore të kryerësve, dhe mbajnë pozita si kolegë apo eprorë. Në BE, incidenca e ngacmimit seksual duket se është e lidhur me raportin gjinor në vendin e punës: “gratë në vendet e punës të dominuara nga meshkujt kanë përjetuar më shumë ngacmim seksual sesa gratë në vendet e punës ku ka ekuilibër apo që dominohen nga gratë.”⁹⁶

Ka pak hulumtim lidhur me ngacmimin seksual në vendin e punës në Kosovë. Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj) ka gjetur në vitin 2010 se 9% e nëpunësve civilë janë ngacmuar seksualisht më shumë sesa tri herë, ndërsa 7.6% kanë qenë vetëm një herë viktimë të ngacmimit seksual.⁹⁷ QKSGj-ja ka raportuar se 80% e viktimave janë gra, ndërsa 70% e kryerësve ishin burra. Nëpunësit civilë të moshës nga 21 deri 35 vjeç kishin më shumë të ngjarë të ngacmoheshin, ndërsa ngacmuesit prireshin të ishin nga 35 deri 41 vjeç.

Të dhënat e përmendura më sipër të anketimit të RrGGK-së lënë të kuptohet edhe se ngacmimi seksual ndodh në vendet e punës në Kosovë, dhe kryhet nga eprorët dhe kolegët (shihni grafikun 11). Është e vështirë të dihet me saktësi se sa i përhapur është ky lloj ngacmimi, duke marrë parasysh problematikën e nën-raportimit, e cila shfaqet edhe këtu. Për shkak të normave të larta të papunësisë në Kosovë⁹⁸, njerëzit mund të kenë frikë të raportojnë rastet e ngacmimit seksual (madje edhe në

⁹⁴ FRA, *Dhuna kundër grave: një studim i mbarë BE-së: Rezultatet në një shikim*, 2014, fq. 12-13.

⁹⁵ Komisioni Evropian, *Ngacmimi Seksual në vendin e punës në Bashkimin Evropian*, EC, 1998.

⁹⁶ Ibid.

⁹⁷ QKSGj, *Perceptimet e shërbyesve civilë në Kosovë lidhur me ngacmimin seksual në vendin e punës*, Prishtinë, QKSGj, 2011. Në këtë studim u anketuan 200 punonjës të shërbimit civil në nivelin qendror dhe 300 punonjës në nivelin lokal gjatë periudhës mars-qershor 2010. Ky kampion ka përfshirë punonjësit civilë nga të gjitha nivelet e administratës dhe një numër të barabartë të respondentëve dhe respondentëve. Të pyetur nëse ngacmimi seksual është i pranishëm në institucionet publike në Kosovë, 35.6% e respondentëve besonin se ai ishte i pranishëm, 41.6% u shprehën se ishte “disi i pranishëm”, 12.9% “mungon”, dhe 9.7% nuk e dinin.

⁹⁸ Shihni anketat për Fuqinë Punëtore.

anketimin social) ngaqë i druhen humbjes së vendit të punës, edhe pse pushimi nga puna i atij që e raporton ngacmimin është i ndaluar me ligjet e Kosovës.⁹⁹

Ngacmimi seksual në shkolla

Në mediet e Kosovës janë publikuar së fundmi disa raste ku është pretenduar se mësime të kanë ngacmuar seksualisht studentë, duke përfshirë edhe hapjen e disa rasteve nga ana e gjykatave. Për shembull, në vitin 2015, në polici janë raportuar dy raste në shkollat e mesme në Mitrovicë dhe Malishevë. Rasti në Malishevë kishte të bënte me një mësime të cili pretendonte se e kishte ngacmuar seksualisht njërin prej studenteve të tij përmes medias sociale.¹⁰⁰

“Profesorët s’ta japin notën po s’u shkove në zyrë.”

- Grua, 40 vjeçe, Gjiilan

Vetëm 2.4% e të anketuarve kanë thënë se ndonjë mësime të kishte prekur në një mënyrë seksuale e cila i kishte bërë të mos ndiheshin rehat në një moment të jetës së tyre, ndërkohë që katër respondentë thanë se kjo kishte ndodhur në vitin 2014. Edhe pse raportimi i abuzimit seksual nga

“Kur punoja si mësime, një nxënës u ankua se një mësime tjetër e ngacmonte seksualisht.”

- Grua, 43 vjeçe, Mitrovicë

mësime të, në përgjithësi ishte i ulët, pak më shumë gra (2.4%) sesa burra (1.7%) raportuan se ishin prekur në mënyrë seksuale nga mësime të tyre kur ishin më të vegjël. Për tre respondentë, ngacmimi seksual nga mësime të ka ndodhur 1-4 herë gjatë vitit 2014 dhe për një respondent, 5-11 herë. Edhe pse si gratë ashtu edhe burrat kanë përjetuar

ngacmim seksual nga mësime të tyre, gratë përbënin një shumicë pak më të madhe të personave të prekur. Duke marrë parasysh ndjeshmërinë e kësaj çështjeje, mund të ketë nën-raportim.

Shqetësimi për ngacmimin seksual në institucionet arsimore ka qenë një çështje që është shfaqur nga disa përfaqësues të ndryshëm të institucioneve, të intervistuar nga RrGGK-ja në vitin 2015. Në disa raste, kjo ndodhte sepse respondentët njihnin vetë raste të drejtpërdrejta, ndërsa në disa raste të tjera ata shprehnin shqetësim për rastet për të cilat kishin lexuar në medien lokale apo kombëtare. Të intervistuarit thanë se pjesa më e madhe e viktimave të ngacmimit rrinin të heshtura, dhe nuk e çonin rastin në gjykatë. Në vend që të vepronin kështu, ata e menaxhonin rastin “së brendshmi”. Me fjalë të tjera, shkollat zakonisht i raportojnë rastet në drejtoritë arsimore dhe i pezullojnë mësime të akuzuar për ngacmim seksual. Kjo është në harmoni me Ligjin për Arsimin Para-Universitar në Republikën e Kosovës, ku në nenin 7, paragrafi 3.4, përmendet se komunat janë përgjegjëse për kompetencat duke përfshirë “përmes bashkëpunimit me prindër, polici dhe autoritetet e tjera publike, marrjen e hapave për të adresuar sjelljet e dhunshme dhe keqpërdorimin në ose në lidhje me institucionin përkatës.”¹⁰¹ Megjithatë, nëse ndodh ndonjë vepër penale, ajo duhet edhe të ndiqet penalisht sipas detyrës zyrtare (*ex officio*), përtej procedurave të brendshme.

Pasojat e ngacmimit seksual

Pjesa më e madhe e kosovarëve besojë se ngacmimi dëmton personin që ngacmohet (70.4%), edhe pse 17.2% e konsiderojnë ngacmimin të padëmshëm. Disa prova në formën e rasteve dhe përvojave individuale lënë të kuptohet se ngacmimi seksual mund të ketë ndikime negative në shëndetin dhe mirëqenien e viktimave. Një

“Nuk dal vetëm sepse nuk ndihem e sigurtë.”

- Grua, 48 vjeçe, Mitrovicë

⁹⁹ Ligji për Barazinë Gjinore, neni 4, paragrafi 6 e ndalon viktimizimin.

¹⁰⁰ Newsbomb, *Arrestohet një tjetër mësime në Kosovë për ngacmim*, 27 mars 2015, marrë nga:

<http://www.newsbomb.al/index.php/rajon/item/7157-arrestohet-nje-tjeter-mesues-ne-kosove-per-ngacmim-seksual>.

¹⁰¹ Republika e Kosovës, Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Para-Universitar në Republikën e Kosovës, neni 7, Kompetencat e Komunave, paragrafi 3.4, 2011, marrë nga:


<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20arsimin%20parauniversitar.pdf>.

studim vertikal nga Munson, J. et al., lidhur me ndikimin e ngacmimit seksual te anëtarët e personelit dhe fakultetit në Universitetin “Midwestern” në Shtetet e Bashkuara sugjeron se “ngacmimi seksual ka pasojë të konsiderueshme në rezultatet psikologjike dhe ato të ndërlidhura me punën.”¹⁰²

Sikurse është përmendur në hyrje, akti i cili mund të fillojë si ngacmim mund të kthehet në një formë e dhunshme e dhunës seksuale, e cila mund të ketë shumë rrjedhoja për mirëqenien psikologjike dhe fizike të viktimave.¹⁰³ Për shembull, një i anketuar tha se ngacmimi seksual kishte çuar në lëndime trupore, meqenëse kryerësi kishte përdorur një thikë te viktimë.¹⁰⁴ Në një rast tjetër, një anketuese tha se një shoqe e saj, të cilën e kishin përdhunuar, e kishte raportuar rastin në polici dhe megjithëse burrin e arrestuar, gruaja më vonë kreu vetëvrasje.¹⁰⁵ Efektet psikologjike dhe fizike të dhunës seksuale në Kosovë janë diskutuar gjetkë, ndaj nuk janë shtjelluar më shumë këtu.¹⁰⁶

Reagimet e qytetarëve ndaj ngacmimit seksual

Për 66.9% të respondentëve, të cilët kishin përjetuar ngacmime në rrugë, reagimi i tyre më i zakonshëm ishte injorimi i personave që i ngacmonin (87.3% e grave dhe 25.4% e burrave) (shihni grafikun 12). Më pak respondentë (66) u ishin përgjigjur me fjalë ose kishin qeshur me personat që i ngacmonin (40). Vetëm gjashtë respondentë thanë se ishin përgjigjur fizikisht, ndërsa tri gra thanë se kishin ikur. Një burrë u shpreh se ndaloi për të folur me të. Mes gjithë personave që kishin përjetuar ngacmim seksual, vetëm dy gra thanë se e kishin raportuar incidentin te autoritetet përkatëse.



Personat që kishin përjetuar ngacmim seksual u pyetën nëse dikush tjetër ishte dëshmitar për aktin. Pjesa më e madhe e personave që kishin përjetuar ngacmim seksual (257 gra dhe 58 burra) thanë se dëshmitarët e injorin ngacmimin (shihni grafikun 13). Reagimi tjetër më i zakonshëm i dëshmitarëve ndaj ngacmimit (sipas 72 grave dhe 17 burrave) ishte ta mbronin personin e ngacmuar. Fare pak respondentë thanë se dëshmitarët i kishin mbrojtur ata fizikisht ndaj ngacmuesve (nëntë); u kanë qeshur ngacmuesve (shtatë); i kanë parë ngultas (dy); ishte frikësuar (një). Në njërin rast, dëshmitari iu bashkua ngacmimit ndaj personit. Vetëm dy ishin rastet ku dëshmitarët e kishin raportuar te autoritetet përkatëse ngacmimin seksual që kishin parë, thanë respondentët.

¹⁰² Munson, J. et.al., *Analizë vertikale e ndikimit të përvojës dhe efekteve të ngacmimit seksual në vendin e punës dhe pasojat psikologjike*, Illinois: 2000.


¹⁰³ Për informata të mëtejme lidhur me rrjedhojat negative të mundshme që mund të ketë ngacmimi seksual tek femrat, duke përfshirë shëndetin e tyre riprodhues, shihni raportin e RrGGK-së, *Hulumtim kërkimor mbi nivelin e Dhunës në Baza Gjimore në Kosovë dhe ndikimin e tij në Shëndetin Riprodhues të Grave*, Prishtinë: RrGGK, 2008, marrë nga: <http://www.unfpakos.org/wp-content/uploads/2012/05/TheExtentofGBVandItsImpactonWomensRH-Albanian.pdf>.

¹⁰⁴ Burrë, 22 vjeç, Prishtinë

¹⁰⁵ Grua, 32 vjeçe, Glogoc.

¹⁰⁶ Për shembull, shihni RrGGK-në: *Hulumtim kërkimor mbi nivelin e Dhunës në Baza Gjimore në Kosovë dhe ndikimin e tij në Shëndetin Riprodhues të Grave*,

Grafiku 13. Si reagon dëshmitarët ndaj ngacmimit seksual sipas gjinisë së personave që ishin të ngacmuar



Disa të anketuar thanë se u kishin treguar shokëve ose anëtarëve të familjes për forma “më të lehta” të ngacmimit seksual që kishin përjetuar në rrugë.¹⁰⁷ Disa ia kishin raportuar ngacmimin që ndodhte në shkolla drejtorit të shkollës, dhe një vajzë në vitin 2015 raporti abuzim nga një mësimitdhënës në polici.¹⁰⁸ Një

“Më kanë ngacmuar për një vit e tre muaj, por nuk e raportova rastin në polici sepse kam pasur frikë.”

- Grua, 39 vjeçe, Istog

respondent tjetër tha se kishte ofruar strehë brenda familjes së tij për një viktimë të dhunës seksuale që kishte kërkuar ndihmë.¹⁰⁹ Megjithatë, vetëm 4.1% e gjithë të intervistuarve kanë raportuar ndonjë rast të ngacmimit seksual te autoritetet ose madje njihnin dikë që kishte vepruar kështu.¹¹⁰ Frika nga zyrtarët, fqinjët, apo anëtarët e familjes “nga fajësimi i viktimës”, ose edhe më keq, siç është përjashtimi, mund t’i pengojë gratë dhe burrat në raportimin e ngacmimit seksual.

Përfundime

Gjetjet e anketimit lënë të kuptohet se ngacmimi seksual prek shumë njerëz në Kosovë, duke marrë parasysh se vlerësohet në 48.5% pjesa e kosovarëve të cilët kanë përjetuar ndonjë formë të ngacmimit seksual në jetën e tyre. Gratë kanë konsiderueshëm më shumë të ngjarë sesa burrat që të kenë përjetuar ngacmim seksual. Individët e moshave 18-25 vjeç kanë më shumë të ngjarë të raportojnë se kanë përjetuar ngacmim seksual, ndërsa personat nga 46 vjeç e sipër kanë më pak të ngjarë të raportojnë se kanë përjetuar ngacmim. Ngacmimi në rrugë duket se është prej formave më të zakonshme të ngacmimit seksual në Kosovë. Ngacmimi seksual vjen kryesisht nga persona të panjohur, por edhe nga të njohur, shokë, kolegë pune, mësimitdhënës, shefat në punë si dhe partnerët. Në rastet kur ka ngacmim seksual, pjesa më e madhe e njerëzve kanë prirjen ta injorojnë atë, çka kontribuon në mungesën e raportimit. Në fakt, vetëm 4.1% e të gjithë respondentëve e kanë raportuar ngacmimin seksual te autoritetet ose kanë njohur ndonjë person që e ka bërë këtë.

¹⁰⁷ Respektivisht, burrë, 20 vjeç, Prishtinë dhe grua, 21 vjeç, Prishtinë.

¹⁰⁸ Burrë, 21 vjeç, Gjakovë.

¹⁰⁹ Burrë, 38 vjeç, Deçan.

¹¹⁰ Në respondentë mori në telefon policinë pas një dhunimi në tentativë, i cili kishte ndodhur para pesë vitesh (burrë, 41 vjeç, Skenderaj, anketim i RrGGK-së, 2015).

REAGIMET INSTITUCIONALE NDAJ NGACIMIT SEKSUAL

Janë realizuar rreth 200 intervista me përfaqësues të institucioneve të ndryshme duke përfshirë Mbrojtësit e Viktimave; Policinë e Kosovës; Qendrat për Punë Sociale; Qendrat për Trajnime Profesionale; Zyrat e Punës; arsimtarët (profesorët e shkollave fillore dhe të mesme, psikologët dhe pedagogët); Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve; Ministrinë e Administratës Publike; Ministrinë e Drejtësisë; Ministrinë e Shëndetësisë; Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik; Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal; drejtoritë komunale të ekonomisë, shëndetësisë, arsimit, dhe ato për mirëqenie sociale; zyrtarët për barazi gjinore; qendrat e kujdesit shëndetësor publik; klinikat private të shëndetësisë; OShC-të, dhe organizata të tjera ndërkombëtare. Të gjitha këto institucione kanë përgjegjësi që në një apo më shumë mënyra të sigurojnë zbatimin e kornizës ligjore të përmendur më sipër e që ka të bëjë me ngacmimin seksual. Për këtë arsye, intervistat kanë kërkuar të shqyrtojnë njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e përfaqësuesve të institucioneve në lidhje me ngacmimin seksual. Krahas kësaj, respondentët janë pyetur nëse institucioni i tyre ka ndonjë politikë e cila e parandalon ngacmimin seksual dhe/ose skicon procedurat për raportimin e tij.

Grafiku 14 ilustron se cilat akte, përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme i konsiderojnë si ngacmim seksual, dhe i ndan këto sipas gjinisë së respondentëve.¹¹¹ Përgjigjet e tjera që nuk janë paraqitur në këtë grafik kanë të bëjnë me rastet kur respondentët nuk e konsideronin një akt të caktuar si formë të ngacmimit seksual, ose kur nuk e dinin nëse ai rast përbënte ngacmim seksual apo jo. RrGGK-ja i konsideron këto përgjigje të ngjashme lidhur me këto pyetje sepse institucionet duhet të dinë nëse këto veprime janë forma të ngacmimit seksual apo jo.

Brenda institucioneve, 81% e grave dhe 74% e burrave mendojnë se shefi që e bën punëtorin/ren të dalë për darkë së bashku me qëllime të tjera veç atyre të punës, është duke bërë një akt që është formë e ngacmimit seksual (shihni grafikun 14). Kjo do të thotë se rreth pesë në tre përfaqësues të institucioneve ose nuk e konsiderojnë këtë si formë të ngacmimit, ose nuk janë të sigurtë. Rastin kur mësimdhënësi/ja i kërkon nxënësit/ses të shkojë natën vonë në zyrë për të marrë notën, 88% e grave dhe 84% e burrave nga institucionet e konsiderojnë si formë të ngacmimit. Të komentuarit e personit në rrugë, që e bën këtë person të ndihet jo rehat, është formë e ngacmimit seksual për 88% të respondentëve. Rreth 90% e burrave dhe grave e konsiderojnë postimin e fotove të një personi tjetër në internet pa lejen e tij si formë të ngacmimit. Kur shefi e prek punëtorin/ren në një mënyrë të cilin punëtori/ja nuk ka dëshirë të preket, përbën formë ngacmimi për 90% të grave dhe 93% të burrave që janë intervistuar. Rasti kur kolegu/ia bën komente të natyrës seksuale për kolegen/un, përbën ngacmim seksual sipas mendimit të 85% të grave dhe 91% të burrave në institucione.

Pjesa më e madhe e respondentëve nga institucionet i konsiderojnë këto raste si forma të ngacmimit seksual: kur një burrë ngacmon një grua (90%), kur një burrë ngacmon një burrë (89%), dhe kur një grua ngacmon një burrë (89%). Disi më i ulët është numri i atyre që besojnë se rasti kur një grua ngacmon një grua tjetër mund të përbëjë ngacmim seksual (88%). Pak më e lartë sesa ajo e burrave ka qenë përqindja e grave të cilat priren të mendojnë se ngacmimi mund të ndodhë në këto situata.

Shkurtimisht, mund të arrihet në përfundimin se pjesa më e madhe e përfaqësuesve të institucioneve janë të informuar lidhur me atë se cilat akte përbëjnë ngacmim seksual. Megjithatë, pothuaj një e e dhjeta e përfaqësuesve të intervistuar të institucioneve nuk kanë njohuri lidhur me atë se cilat raste përbëjnë ngacmim seksual.

¹¹¹ Respondentët janë përzgjedhur në bazë të pozitës së tyre.

Grafiku 14. Veprimet të cilat përfaqësuesit e institucioneve i konsiderojnë ngacmim seksual, sipas gjinisë

■ Gra ■ Burra ■ Totali




RrGGK-ja u bëri përfaqësuesve të institucioneve një grup tjetër të pyetjeve për të matur informimin e tyre lidhur me kornizën ligjore, si dhe pikëpamjet e tyre lidhur me ngacmimin seksual. Grafiku 15 shfaq përqindjen e respondentëve dhe respondentëve nga institucionet që janë dakorduar me secilin pohim. Kur janë pyetur nëse Ligji Kundër Diskriminimit e ndalon ngacmimin seksual,¹¹² 2% thanë se nuk e ndalon, ndërsa 18% nuk e dinin. Kështu, gjithsej, 20% e respondentëve nga institucionet nuk janë të informuar për ligjin. Rreth 70% e grave dhe 57% e burrave mendojnë se një problem me rastet e ngacmimit seksual është se janë të vështirë për t'u provuar. 18% të respondentëve ishin të pasigurtë. Kjo lë të kuptohet se ekziston një mungesë e përgjithshme e sensibilizimit në radhët e përfaqësuesve të institucioneve të ndryshme lidhur me atë se barra e provës në rastet civile bie mbi kryerësin e pretenduar e jo mbi viktimën.

Më tej, 10% e respondentëve deklaruan se: "Vajzave të reja iu pëlqen të ngacmohen seksualisht", ndërsa 24% nuk e dinin. "Fajësimi i viktimës" duket se është i përhapur në radhët e përfaqësuesve të institucioneve, të cilët RrGGK-ja i intervistoi: 46% e respondentëve nga institucionet e intervistuar thanë se gratë ia sjellin vetes ngacmimin seksual duke u veshur në mënyrë provokative."¹¹³ 62% e respondentëve (burra) nga institucionet e mendojnë këtë, ndërsa 38% e grave bien dakord. Lidhur me qëndrimet brenda institucioneve specifike, 11 nga 19 zyrtarë të policisë dhe 11 nga 17 zyrtarë të shëndetit besojë se gratë i sjellin vet vetes probleme me ngacmimin; tetë përfaqësues të shkollave, dhe, çka është shqetësuese, disa zyrtarë për barazinë gjinore, ranë dakord, sikurse edhe pak përfaqësues të Qendrave për Punë Sociale, Qendrat për Trajtime Profesionale dhe Mbrojtësit e Viktimave.

¹¹² RrGGK-ja ka bërë pyetje lidhur me ligjin e vjetër kundër diskriminimit, meqenëse ligji i ri nuk ishte miratuar ende në kohën kur janë realizuar intervistat.

¹¹³ Intervista të RrGGK-së me përfaqësues të institucioneve të përmendura në Shtojcën 3.

Graph 15. Institutional Representatives that Agree with the Following Statements



Sikurse paraqitet në grafikun 15, 10% e respondentëve dhe 23% e respondentëve nga institucionet bien dakord që “njerëzit natyrshëm ngacmojnë të tjerët kur kanë tërheqje ndaj tyre dhe kjo është në rregull.” Katër për qind e zyrtarëve dhe zyrtarëve bien dakord se, “ngacmimi seksual nuk i bën asgjë të keqe personit që ngacmohet.” Së fundmi, të pyetur nëse mendonin se ngacmimi seksual në vendin e punës mund të bëhet nga eprorët, vetëm 2% e grave dhe 10% e burrave ranë dakord.

Pjesa më e madhe e zyrtarëve të intervistuar kanë thënë se ata kanë Kode të Mirësjelljes, të cilët e ndalojnë ngacmimin seksual. Megjithatë, në këto dokumente nuk kishte prirje që ngacmimi seksual të adresohet në mënyrë specifike. Sikurse tha një përfaqësues, “Kodi i mirësjelljes rregullohen mënyrën se si vishemi. Por gratë vishen ‘jo siç duhet’, dhe edhe kjo është formë e ngacmimit seksual.”¹¹⁴ Pohime të ngjashme janë bërë edhe nga përfaqësues të institucioneve të tjera, të cilët fajësonin gratë, duke i konsideruar ato si përgjegjëse për ndodhjen e ngacmimit seksual. Kjo shfaq mungesën e vetëdijesimit lidhur me atë se çka konsiderohet ngacmim seksual.

“Është e tmerrshme kur profesori i kërkon studentit të shkojë në zyrën e tij për të marrë notën, ndërkohë që ka qëllime të tjera. Ata duhet të jenë si prindër të dytë për nxënësit.”

- Grua, 55 vjeçe, Pejë

Pjesët e mëposhtme i shqyrtojnë më tej reagimet institucionale ndaj ngacmimit seksual, brenda institucioneve specifike. Kjo pjesë shqyrton gjithashtu edhe atë se cilët mekanizma kanë institucione të ndryshme për parandalimin dhe/ose raportimin e ngacmimit seksual kur ai ndodh brenda atij institucioni të caktuar. RrGGK-ja ka marrë informata shumë të kufizuara nga përfaqësuesit e institucioneve të cilët janë intervistuar në kuadrin e këtij hulumtimi. Kjo do të thotë se ose ata nuk janë të informuar mirë, ose mekanizmat zyrtarë që merren me ngacmimin seksual brenda institucioneve janë të paqarta ose nuk ekzistojnë.

¹¹⁴ Intervistë e RrGGK-së, 2015.

Nëpunësit civilë në nivelin komunal

RrGGK-ja ka intervistuar përfaqësues të Qendrave për Punës Sociale (QPS), Qendra për Trajtime Profesionale (QTP), Zyra të Punës dhe Drejtoritë Komunale. Edhe pse këto institucione kanë fushëveprime të ndryshme të punës, emëruesi i përbashkët është se ato u ofrojnë qytetarëve shërbime. Gjithashtu, e përbashkëta tjetër e këtyre institucioneve është se të gjithë nëpunësit civilë komunalë duhet të veprojnë në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil dhe Kodin e Sjelljes të Shërbyesit Civil të Republikës së Kosovës, një rregullore kjo e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2015. Kjo rregullore nuk e adreson drejtpërdrejt ngacmimin seksual, por tërthorazi. Neni 4 parasheh parimet e mos-diskriminimit dhe në të shkruhet: “Nuk lejohet kurrfarë diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.”¹¹⁵ Më tej, në nenin 5 shkruhet se nëpunësit civilë “duhet të udhëhiqen nga parimi i pavarësisë profesionale, integritetit personal, përgjegjshmërisë dhe ndershmërisë” dhe “nuk duhet të keqpërdorin pozitën e tyre zyrtare për interesin e tyre personal apo interesin e dikujt tjetër.” Fakti që kjo rregullore është miratuar kohëve të fundit mund të shpjegojë se pse disa zyrtarë nuk kanë njohuri për të.¹¹⁶

QKSGj gjeti se 39.8% e nëpunësve civilë kanë thënë se ishin të informuar për “rregulloret, politikat dhe kodet të cilat adresojnë në mënyrë specifike çështjen e ngacmimit seksual në vendin e punës,” ndërsa 22.2% nuk ishin të informuar ndërkohë që 36.1% nuk kishin informata.¹¹⁷ Intervistat e RrGGK-së me nëpunësit civilë në institucionet e përmendura më sipër lënë të kuptohet se ata ende kanë mangësi në njohuri lidhur me atë se cilat ligje janë të ndërlidhura me këtë çështje dhe cilat akte përbëjnë ngacmim seksual. Për më tepër, disa shërbyes civilë nuk duket se e konsiderojnë ngacmimin seksual si të rëndësishëm. Një zyrtar nga njëra prej komunave, u shpreh: “Kush mund ta ndalojë? Kur të rinjtë e kërkojnë vet, atëherë çka?”¹¹⁸

Për shkak të përgjegjësisë ligjore që kanë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve (persona nën 18 vjeç), përfaqësuesit e QPS-së kanë prirjen të jenë disi më të vetëdijshëm për mbrojtjen e fëmijëve nga ngacmimi seksual. Përfaqësuesit e QPS-ve përmendin Kodin Penal si bazën ligjore për adresimin e rasteve të ngacmimit seksual. Megjithatë, pak përfaqësues të QPS-ve duket se kanë njohuri për ligje të tjera të ndërlidhura. Katër punonjës socialë kanë përmendur raste të ndihmimit të fëmijëve të cilët kishin qenë viktimë të ngacmimit seksual. Më tej, përfaqësuesit e QPS-ve deklaruan se kanë një mjedis pune miqësor, dhe, për këtë arsye, nuk kanë dëgjuar asnjëherë për raste të ngacmimeve seksuale midis kolegëve. Vetëm një respondent përmendi një rast të një drejtori i cili ngacmonte seksualisht një punonjës social gjatë turnit të natës. Megjithatë, raportohet se drejtori e humbi punën.

Përfaqësuesit e QTP-ve në përgjithësi janë të informuar për atë se çka përbën ngacmim seksual dhe ligjet të cilat i mbrojnë qytetarët nga ngacmimi. Ata gjithashtu përmendën edhe Kodin e Mirësjelljes për nëpunësit civilë. Kodi zakonisht afshohet publikisht në vendin e tyre të punës, për t’u kujtuar përfituesve se si duhet të sillen gjatë qëndrimit në qendrat e trajnimit, thanë respondentët. Përfaqësuesit e QTP-ve thanë se nuk kishin qenë dëshmitarë të asnjë rasti të ndonjë ngacmimi seksual në vendet e tyre të punës, midis kolegëve të tyre. Megjithatë, ata kishin parë raste të përfituesve burra të cilët ngacmonin seksualisht përfitueset gra. Në një rast, një personi që po ndiqte një kurs në QTP raportohet se iu ndërpre trajnimi nga Drejtori i QTP-së sepse ishte duke ngacmuar seksualisht gratë që po trajnoheshin.

Përfaqësuesit e zyrës së punës kanë prirjen të pohojnë se nuk kanë asnjë rregullore që merret me ngacmimin seksual në institucionin e tyre. Ata duket se nuk janë të njohur me përkufizimet e ngacmimit seksual dhe kornizës ligjore përkatëse. Punonjësit nuk dinë të kenë ndodhur në institucionin e tyre raste të ngacmimit seksual.

¹¹⁵ Qeveria e Republikës së Kosovës, *Rregullore (QRK) – nr. 04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës*, 2015, marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10764>.

¹¹⁶ Intervista me RrGGK-në, 2015.

¹¹⁷ QKSGj, 2011, fq. 13.

¹¹⁸ Intervistë e RrGGK-së me një përfaqësues nga Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore dhe Sociale, 2015.

Përhapja e mungesës së njohurive dhe indiferenca për ngacmimin seksual në radhët e disa nëpunësve civilë mund të shpjegojë pjesërisht arsyen pse pak janë marrë me raste të ngacmimit seksual. Përfundimisht përbënin përfaqësuesit e Drejtorive Arsimore të cilët kishin prirjen të përmendnin raste të ngacmimit seksual ndaj nxënësve.

Shkollat dhe universitetet

Universiteti i Prishtinës ka një Kod të Mirësjelljes, i cili, siç thonë zyrtarët, rregullon në teori ngacmimin seksual, dhe përfaqësuesit e universiteteve të tjera publike kanë deklaruar se ndjekin të njëjtin Kod.¹¹⁹ Megjithatë, termi “ngacmim seksual” nuk përmendet në mënyrë specifike në Kod. Neni 8 i Kodit rendit aktet të cilat nuk lejohen të ndodhin në marrëdhëniet profesor-student. Këtu bëjnë pjesë: vendosja e kushteve për përmbushjen e kërkesave të mësimi, kalimi i provimeve duke u kërkuar studentëve të blejnë literaturën e caktuar apo mjete të tjera mësimore, ose duke u kërkuar favore politike, seksuale, financiare, ose të tjera me peshë” (neni 8.3).¹²⁰ Në të gjithashtu përmendet se nuk lejohet: “diskriminimi, duke përfshirë ngacmimet kundër një studenti në baza politike ose për shkak të racës, ngjyrës, fesë, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, origjinës etnike, origjinës kombëtare, prejardhjes, statusit martesor, shtatzënisë, paafësisë fizike apo mendore” (neni 8.4).¹²¹ Megjithatë, sanksionet për angazhimin në këto sjellje dhe mekanizmi përmes së cilit studentët mund t'i raportojnë këto sjellje nuk janë mjaftueshëm të qarta. Kodi thjesht pohon se kur anëtarët e personelit akademik nuk veprojnë në pajtim me Kodin, ata duhet të raportohen te këshilli i etikës, autoritetet drejtuese të njësisë akademike, apo rektori. Çdo shkelje e raportuar tek ky i fundit duhet patjetër të kalojë përmes këshillit të etikës. RrGGK-ja nuk ka mund të identifikojë nëse ndonjë kolegj privat apo universitet ka rregullore të ngjashme, edhe pse mund të ekzistojnë.¹²²

Ligji për Arsimin Para-Universitar i detyron drejtoritë arsimore në komuna, që në bashkëpunim me policinë, prindërit, dhe institucionet e tjera të ndërlihdura, të reagojnë në rast se në shkolla apo pranë saj ndodh ndonjë kundravajtje.¹²³ Të pyetur për politikën që ekzistojnë lidhur me parandalimin e ngacmimit seksual në shkolla, asnjë prej respondentëve nga institucionet arsimore apo drejtorëve të drejtorive arsimore në tetë komuna të ndryshme, që u intervistuan, nuk përmendi se këto politika ekzistojnë. Më tej, vetëm pak mësimdhënës shkollorë, pedagogë, apo psikologë kishin njohuri lidhur me atë se cilat ligje i mbrojnë qytetarët nga ngacmimi seksual. Mungesa e përgjithshme e njohurive lidhur me atë se çka përfshin ngacmimi seksual, cilat janë përgjegjësitë e tyre ligjore, si dhe mekanizmat për raportimin e tij, ka të ngjarë ta minojë mundësinë e shumë mësimdhënësve që të parandalojnë apo marrin veprime për të adresuar me efektivitet ngacmimin seksual.

Disa përfaqësues të institucioneve thanë se dinin për shumë raste të ndodhjes së ngacmimit seksual në shkolla dhe universitete.¹²⁴ Si studentët ashtu edhe profesorët kanë raportuar se ngacmimi seksual ndodh shpesh në Universitetin e Prishtinës.¹²⁵ Ka të ngjarë që rastet e tjera nuk raportohen. Frika nga ndëshkimi nga mësimdhënësit apo profesorët mund t'i pengojë nxënësit/studentët në raportimin e ngacmimit seksual. Siç thotë edhe psikologja Michele Paludi, “Gratë, të cilat kanë përjetuar ngacmim seksual, janë në një pozitë të papushtetshme në raport me ngacmuesin (p.sh. studenti me

¹¹⁹ Intervistë e një anëtari të RrGGK-së me një zyrtar të universitetit, 2015.

¹²⁰ Kodi i Etikës i Stafit Akademik të Universitetit të Prishtinës, 19 korrik 2013, marrë nga: <http://uni-pr.edu/getattachment/Kerkime-Shkencore/Rregulloret/Rregulloret-e-Senatit/Kodi-i-Etikës-i-stafit-akademik-te-Universitetit-te-Prishtines-Hasan-Prishtina-%281%29.pdf.aspx>.

¹²¹ Ibid.

¹²² Dy universitete private thanë për RrGGK-në se nuk kishin kode të tilla (bashkëbisedim telefonik, shkurt 2016).

¹²³ Republika e Kosovës, Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Para-Universitar në Republikën e Kosovës, neni 7 Kompetencat e Komunës, paragrafi 3.4.

¹²⁴ Intervista të RrGGK-së, 2015. në Kosovë, arsimtarëve të shkollës fillore iu thonë “mësimdhënës”, ndërsa atyre të shkollës së mesme dhe universitetit, “profesorë”.

¹²⁵ Orgut Consulting, *Profil Gjini i Kosovës*, fq. 22. Gjithashtu, edhe bashkëbisedime të RrGGK-së me studentë dhe anëtarë të stafit të fakultetit, 2015.

profesorin) ... gratë besojë se ato vetë duhet të merren me ngacmimin, se nuk ka kuptim të protestohet publikisht, sepse askush nuk do t'i besonte.”¹²⁶

Në të vërtetë, edhe në ato pak raste kur janë raportuar profesorë që kanë ngacmuar seksualisht studentë, këto raporte nuk janë adresuar.¹²⁷ Për shembull, një psikolog shkollor përmendi “një rast ku një mësimitdhënës i dërgonte jashtë klase djemtë dhe u jepte mësim vetëm vajzave, dhe ua prekte duart. Kur një vajzë ngriti zërin, klasa nuk e mbështeti atë sepse mësimitdhënësi u kishte premtuar të gjithëve nota të mira [po të mos flisnin].”¹²⁸ Raportohet se ky mësimitdhënës ka dalë në pension dhe ndaj tij nuk është marrë asnjë masë disiplinore. Në një rast tjetër, një psikolog i një shkolle fillore u shpreh: “Ne kemi pasur dy raste të ngacmimit seksual, që janë raportuar në shkollën tonë. Mësimitdhënësit e akuzuar u pezulluan nga Drejtoria Komunale e Arsimit, por tani ata punojnë përsëri si mësimitdhënës, vetëm se punojnë në një shkollë tjetër.”¹²⁹ Në dy raste, të anketuarit thanë se mësimitdhënësit ishin pushuar nga puna nga institucionet arsimore pasi ata dhe/ose shokë të tyre kishin raportuar ngacmimin seksual.¹³⁰

Policia

Përfaqësuesit e intervistuar të policisë thanë se ata nuk kanë ndonjë rregullore specifike për trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual në polici. Megjithatë, ata kanë rregullore të tjera, domethënë Kodin e Mirësjelljes të Policisë së Kosovës, në përputhje me të cilin duhet të veprojnë zyrtarët. Kodi i Mirësjelljes rregullon veprimet e policisë brenda institucionit, por edhe kontaktin e policisë me qytetarët. Ky kod mund të interpretohet në vija të përgjithshme për të parandaluar ngacmimin seksual midis punonjësve të policisë dhe përmban edhe sanksione. Për shembull, në nenin 26 shkruhet se:

Marrëdhëniet ndërmjet zyrtarëve policor janë të bazuara në përcaktimin e rendit hierarkik, të respektit, ndihmës, solidaritetit të ndërsjellë, kolegialitetit e shoqërimit, tolerancës, sinqeritetit, besimit dhe dinjitetit të dyanshëm. Këto ndryshime duhet të inkurajojnë dialog të dyanshëm dhe profesionalizëm të lartë në profesionin e zyrtarit policor. Në marrëdhëniet e brendshme nuk mund të zënë vend dukuritë si poshtërimi, nënvlerësimi dhe përbuzja.¹³¹

Neni 8 parashikon trajtimin që policia duhet t’u bëjë qytetarëve:

Gjatë zbatimit të autorizimeve, detyrave dhe procedurave zyrtare në raport me qytetarët, zyrtari policor duhet të veprojë me vendosmëri por njëkohësisht të jetë i përmbajtur, i kujdesshëm, të mos cenoj nderin e prestigjin dhe të mos i shqetësoj pa nevojë ose mos t’iu imponojë atyre obligime të panevojshme. Vëmendje të veçantë zyrtari policor duhet t’iu kushtoj personave që kanë nevojë për ndihmë dhe kujdes të shtuar.¹³²

Pra, Kodi nuk e përmend tekstualisht ngacmimin seksual, por i referohet në terma më të përgjithshëm ruajtjes së nderit, respektit dhe dinjitetit. Zyrtarët policorë kanë prirjen të jenë të informuar për kodin e tyre dhe sanksionet që ekzistojnë për ata të cilët nuk e respektojnë atë. Ata kanë raportuar edhe se kanë marrë trajnime për ngacmimin seksual në Akademinë e Policisë.

Krahas Kodit të Etikës së Policisë së Kosovës, pjesa më e madhe e zyrtarëve policorë i referoheshin Kodit Penal të Kosovës kur pyeteshin për atë se cilat ligje mund të përdreshin kur kishin

¹²⁶ Paludi, Michele Antoinette, *Ivory Power: Sexual Harassment on Campus* [Pushteti i fildishtë: Ngacmimi seksual në konvikt, 1990], New York, fq. 2, marrë nga:

<https://books.google.com/books?hl=en&lr=&id=PQfbumfZfu8C&oi=fnd&pg=PA73&dq=impact+of+sexual+harassment+on+n+victims&ots=azSXll6Ev3&sig=JLo2flF--By5ggBo6YdXx8jcpQ0#v=onepage&q&f=false>.

¹²⁷ Orgut Consulting, *Profili Gjinnor i Kosovës*, fq. 22. shtu, edhe bashkëbisedime të RrGGK-së me studentë dhe anëtarë të stafit të fakultetit, 2015.

¹²⁸ Intervistë e RrGGK-së me një psikolog shkolle, 2015.

¹²⁹ Intervistë e RrGGK-së me një mësimitdhënës, 2015.

¹³⁰ Grua, 65 vjeçe, Gllogoc dhe grua 32 vjeçe Ferizaj.

¹³¹ Policia e Kosovës, *Kodi i Etikës së Policisë së Kosovës*, marrë nga:

http://www.kosovopolice.com/repository/docs/kodi_ietikes.pdf.

¹³² Ibid.

të bënin me raste të ngacmimit seksual. Megjithatë, disa zyrtarë policorë nuk kanë njohuri për ligjet e përmendura më sipër, të cilat janë të ndërlidhura me rastet e ngacmimit seksual. Për shembull, një zyrtar u shpreh se në gjykatë shkojnë pak raste sepse “rastet e ngacmimit seksual janë shumë të vështira të provohen nëse nuk raportohen ditën kur ndodhin.”¹³³ Pjesa “ngacmimi seksual është i vështirë të provohet” ishte një çështje që përmendej në radhët e zyrtarëve policorë. Disa zyrtarë dukeshin se nuk kishin njohuri se sipas ligjeve kundër diskriminimit,¹³⁴ barra e provës bie te kryerësi dhe jo tek viktimat.

Katër zyrtarë policorë të intervistuar thanë se tek ta ishin raportuar raste të ngacmimit seksual. Megjithatë, kur ishin shqyrtuar, historitë e tyre linin të kuptohej se ata e kishin keqkuptuar ngacmimin seksual për sulm seksual apo përdhunim, në vend që ta kuptonin si ngacmim. Për shembull, siç shpjegoi njëri prej tyre, kur raportohen rastet e ngacmimit seksual, viktimat intervistohet nga policia dhe dërgohet te doktori. “Nëse është një rast shumë serioz, ata dërgohen menjëherë në emergjencë. Për të verifikuar nëse ka ndodhur ndonjë gjë, ata dërgohen te mjekësia forenzike.”¹³⁵ Ndërkohë që këto procedura me gjasë do të aplikoheshin për raste të përdhunimit apo sulmit seksual, ato ndoshta nuk duhet të zbatohen në rast se rast përfshin vetëm ngacmimin. Intervistat e RrGGK-së lënë të kuptohet se disa zyrtarë policorë e ngatërrojnë ngacmimin seksual me krime të tjera, si sulmi seksual apo përdhunimi. Vetëm kur pyeten për më shumë detaje, disa zyrtarë përmendin “çdo prekje të padëshiruar”, “filmimin pa miratim”, dhe “akte të tjera jofizike”, si forma të ngacmimit seksual. Duke marrë parasysh që zyrtarët policorë janë shpeshherë të partë që reagojnë ndaj raporteve për ngacmime seksuale, zyrtarët policorë duhet të kenë më shumë njohuri lidhur me kornizën ligjore në fuqi, për sa i takon ngacmimit seksual.

Meqenëse ngacmimi seksual nuk përcaktohet në mënyrë eksplicite në Kodin Penal, është e vështirë të dihet me saktësi se sa raporte për ngacmim seksual ka marrë policia. Tabela 2 përshkruan krimet e ndryshme të raportuara në polici gjatë periudhës 2010-2015 të cilat mund të kenë përfshirë ngacmim seksual ose jo.

Neni	Vepra penale	2010	2011	2012	2013	2014	2015
193/230	Dhunimi dhe dhunimi i mbetur në tentativë	41	30	43	33	36	37
195/232	Sulmi seksual	47	52	58	48	54	54
196/233	Degradimi i integritetit seksual	4	7	7	10	1	2
197/234	Keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime ose paafësi mendore apo emocionale	5	3	4	8	9	4
198/235	Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare	44	52	45	54	56	65
199/236	Nxitja e akteve seksuale, prekjës apo aktiviteteve nga personat nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare	3	0	0	4	5	2
200/239	Keqpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin	1	3	5	4	2	1
203/237	Ofrimi i materialit pornografik personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare	0	0	0	1	1	0
208/247	Bashkësia jashtëmartesore me personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjeçare	18	22	27	24	16	19

Në vitet 2013 dhe 2014, policia ka regjistruar vetëm shtatë raste ngacmimi. Gjetjet e anketimit të RrGGK-së, të përmendur më sipër, lënë të kuptohet se ka të ngjarë të ekzistojnë shumë e shumë raste të tjera të ngacmimit, por që nuk janë raportuar te autoritetet. Intervistat me personat të cilët kanë raportuar ngacmimin seksual në polici lënë të kuptohet se disa zyrtarë të policisë mund të mos i regjistrojnë zyrtarisht të gjitha raportet që marrin lidhur me ngacmimin. Për shembull, RrGGK-së i kanë ofruar këtë informatë:

¹³³ Intervistë e RrGGK-së me zyrtarë policorë, 2015.

¹³⁴ Domethënë, lidhur me ligjin e vjetër që ishte në fuqi në kohën e realizimit të intervistës si dhe ligjin e ri.

¹³⁵ Intervista e RrGGK-së me zyrtarë policorë, 2015.

¹³⁶ Të dhëna që zyrtarë policorë ia kanë ofruar RrGGK-së.

Kur bashkëshorti im punonte në njërin prej stacioneve të policisë në vitin 2011, merrnin një raport çdo javë, në veçanti për ngacmimin në internet. Shpeshherë në Facebook gratë kërcënoheshin nga të dashurit, shokët e të dashurve, ish të dashurit, etj. Gratë kryesisht u thoshin zyrtarëve të policisë se ishte faji i tyre që u kishin dhënë të dashurve fotografitë e veta seksi apo që kishin tërhequr vëmendjen për shkak se më përpara dilnin me atë djalë. Ky rast i vogël më lë të kuptoj se zyrtarët policorë nuk u përgjigjen me seriozitet ankesave të grave, dhe as i regjistrojnë faktin se ato të paktën e bënë një ankesë.¹³⁷

Edhe përvoja të tjera të drejtpërdrejta, që iu raportuan RrGGK-së, lënë të kuptohet se disa zyrtarë të policisë mund t'i konsiderojnë forma të caktuara të ngacmimit si "të parëndësishme" dhe që nuk ia vlen të hetohen më tej.¹³⁸ Megjithatë, ngacmimi përbën një vepër kriminale dhe zyrtarët policorë kanë detyrimin të hetojnë çdo pretendim për ngacmim seksual apo tjetër, që iu raportohet atyre.

"Në prej shoqeve të mia në shkollë u ngacmuar seksualisht 8 vite më parë... asnjë zyrtar policor nuk reagoi."

- Burrë, 29 vjeç, Pejë

Ndryshe nga shembujt e përmendur më sipër, në pak raste, respondentët e sondazhit përmendën raste ku policia kishte ndërmarrë veprime. Një respondente tha: "Një shoqen time e ndiqte dhe e ngacmonte [seksualisht] një djalë. Ajo i telefonoi policisë. Ata morën masa dhe tani ajo është mirë. S'po ndodh më."¹³⁹

Prokurorët

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka hartuar "Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorët në Republikën e Kosovës," i cili është në faqen e tij në internet. Në të thuhet:

[Prokurori] shmanget nga diskriminimi mbi çfarëdo baze duke shmangur çdo sjellje diskriminuese ndaj çdonjërit person apo personave mbi çfarëdo baze, përfshirë gjininë, moshën, statusin martesor, gjuhën, paftësinë mendore apo fizike, orientimin seksual, përkatësinë apo bindjen politike, origjinën etnike, kombësinë, fenë apo besimin, racën, origjinën shoqërore, statusin pronësor, të lindjes, apo çdo status tjetër.¹⁴⁰

Prokurorët kanë prije të dinë për Kodin e tyre, për të cilin thonë se ofron mbrojtje ndaj ngacmimit seksual. Megjithatë, asnjë prej prokurorëve të intervistuar nga RrGGK-ja nuk ka mundur të shpjegojë se si do të mund të përdoret ky Kod në rastet kur ndodh ngacmimi seksual. Një prokuror tha: "E di që është një rregullore e vendosur diku në ndërtesë, por s'e kam parë ndonjëherë."¹⁴¹

Në përgjithësi, prokurorët kanë njohuri për ligjet që trajtojnë ngacmimin seksual dhe që janë në fuqi në Kosovë. Duke marrë parasysh rolet dhe përgjegjësitë e tyre, prokurorët kryesisht përdorin Kodin Penal në hetimin apo parashtrimin e akuzave ndaj personave të dyshuar për ngacmim seksual.

Ndërkohë që ngacmimi seksual nuk përkufizohet si krim specifik në Kodin Penal, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka raportuar se gjatë periudhës 2011-2014 ka ndjekur penalisht disa raste që

¹³⁷ Letërkëmbim me RrGGK-në, 2016.

¹³⁸ Për shembull, një respondentë u shpreh: "Policët erdhën, por nuk ndërmorën asnjë hap tjetër, meqenëse thanë se njerëzit duhet të bëjnë vetë një marrëveshje" (burrë, 31 vjeç, Prishtinë). Në dy raste të tjera, respondentët thanë se kryerësit ishin liruar pa gjyq. Një respondente raportoi se dhjetë vite më parë, shoqja e saj ishte përdhunuar, dhe rasti i ishte raportuar policisë së Drenasit. Mirëpo, pas një viti policia e mbylli rastin (grua, 24 vjeç, Glogoc). Një respondente tjetër tha se policinë e kishin thirrur, por kryerësi ishte liruar për shkak të të njohurve (grua, 30 vjeçe, Prishtinë).

¹³⁹ Grua, 20 vjeçe, nga Skenderaj. Në një rast tjetër të ngjashëm, një respondente tha se njihte një vajzë të cilën e kishte ngacmuar seksualisht një djalë. Ajo e kishte thirrur policinë, dhe zyrtarët policorë kishin marrë masa (grua, 60 vjeç). Një i anketuar tjetër tha se një vajzë 17 vjeçare ishte përdhunuar dhe policia i kishte ofruar asaj ndihmë (grua, 63 vjeçe, Mitrovicë).

¹⁴⁰ Këshilli Prokurorial i Kosovës, "Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorët, Republika e Kosovës", 2012, marrë nga: http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.911.2012-Kodi_i_etikes_per_prokuror.pdf.

¹⁴¹ Intervistë e RrGGK-së me një prokuror nga një gjykatë themelore, 2015.

kishin të bënin me kundërvajtje ndaj integritetit seksual.¹⁴² Numri i veprave penale kundër integritetit seksual, të sjella para prokurorisë, është rritur dukshëm gjatë viteve të fundit, ku në vitin 2014 ka pasur 323 raste të pranuar apo në proces, në të cilën përfshihen të rritur si kryerës të pretenduar, ndryshe nga vetëm 69 raste në vitin 2011 (shihni tabelën 3).¹⁴³ Pjesa më e madhe e rasteve i janë raportuar prokurorisë ose përmes personit juridik të dëmtuar ose policisë. Të dhënat e ofruara nga Këshilli lënë të kuptohet se hetimet në pjesën më të madhe të rasteve ishin në kryerje e sipër në vitin 2013 dhe 2014. Më tej, në vitin 2014, pas hetimeve, janë ngritur 74 aktakuza për të rritur, dhe kanë ndodhur 135 raste. Megjithatë, numri i rasteve të pazgjidhura që kanë të bëjnë me të rriturit, të cilët pretendohen se kanë kryer kundërvajtje ndaj integritetit seksual, i cili ka mbetur në fund të vitit është rritur nga 36 që ishte në vitin 2011 në 189 në vitin 2014. Në vitet 2013 dhe 2014, vetëm një ankesë kundër vendimit të një gjykate është miratuar secilin vit nga gjykata, ndërsa katër ankesa janë hedhur poshtë.

Të gjitha rastet e kundërvajtjeve, të kryera nga të miturit, janë referuar në prokurori nga policia. Numri i rasteve të pazgjidhura në fund të periudhës është në mënyrë të moderuar më e lartë sesa në fillim. Kundër vendimeve të gjykatës nuk janë bërë ankesa për rastet e kryera nga të miturit.

Tabela 3. Procedurat e ndërmarra nga prokuroria dhe vendimet e gjykatësve për rastet e veprave penale kundër integritetit seksual

	Të kryera nga të rriturit				Të kryera nga të miturit			
	2011	2012	2013	2014	2011	2012	2013	2014
Periudha raportuese								
Numri i kallëzimeve të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese	6	6	85	115	11	14	9	12
Numri i personave në kallëzimet penale të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese	6	6	12	157			13	21
Kallëzimi penal është marrë nga: ¹⁴⁴								
• Qytetari i dëmtuar	0	2			0	0		
• Personi juridik i dëmtuar	9	0		119	0	0		
• Policia	17	28	1	2	4	7	12	4
• Organi administrativ: inspektori			1					
• Prokurori i shtetit		3						
• Të tjerë				3				
Numri i përgjithshëm i kallëzimeve penale të pranuar gjatë periudhës raportuese	7	2	100	124	4	8	12	4
Numri i përgjithshëm i personave të paraqitur në kallëzime penale	53	81	52	166	4	15	19	5
Numri i përgjithshëm i kallëzimeve penale të pranuar dhe rasteve të pazgjidhura			185	239	15	29	21	16
Numri i përgjithshëm i personave rastet e të cilave janë në punë	69	117	264	323			32	26
Numri i përgjithshëm i kërkesave për caktimin e paraburgimit			34	38				
Kërkesa të aprovuara			27	22				
Mënyrat e zgjidhjes së kallëzimeve penale sipas personave								
Hedhje e kallëzimit penal	1	1	10	11			2	
Aktakuzë e drejtpërdrejtë			14	13				
Aktakuzë me kërkesë për urdhër ndëshkimor			3					
Masat e mbikqyrjes së shtuar					0	2	4	
Masat disiplinore							3	1

¹⁴² Kodi Penal i Kosovës, Kapitulli XX, përkufizon veprat penale kundër integritetit seksual në të cilat bëjnë pjesë: lajtimi në fakt lidhur me moshën e viktimës (neni 229); dhunimi (neni 230); shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit (neni 231); sulmi seksual (neni 232); degradimi i integritetit seksual (neni 233); keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime ose paafësi mendore apo emocionale (neni 234); keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet (neni 235); nxitja e akteve seksuale, prekjes apo aktiviteteve nga personat nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet (neni 236); ofrimi i materialit pornografik personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet (neni 237); keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi (neni 238); keqpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin (kushdo që e detyron dikë të kryejë një akt seksual) (neni 239); nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës (neni 240); mundësimi ose detyrimi në prostitucion (neni 241); ofrimi i lokaleve për prostitucion (neni 242); marrëdhëniet seksuale brenda familjes (neni 243).

¹⁴³ Të dhëna nga letërkëmbimi me Këshillin Prokurorial të Kosovës, Zyra për Informim, 2015.

¹⁴⁴ Referimet mund të bëhen edhe nga Agjencia Kundër Korrupsionit, Auditori i Përgjithshëm, Përfaqësuesit Financiarë, dhe EULEX-i. Megjithatë, asnjë prej këtyre institucioneve nuk ka referuar ndonjë rast gjatë kësaj periudhë, kështu që nuk janë përfshirë në tabelë.

Urdhër për punë në shërbim të komunitetit									1
Është shqiptuar burgimi për të mitur								1	2
Masa arsimore dhe burgim të minorenëve									2
Aktvendim për fillimin e hetimeve			81		124				
Numri i përgjithshëm i hetimeve në kryerje e sipër, gjatë periudhës raportuese			93		154				
Pezullim i hetimeve					2				
Ndërprerja e hetimeve			6		3		11		
Propozim i akuzave	12		41						
Aktakuza pas procedurës së hetimeve	12		6		60		74		
Hetime të papërfunduara në fund të periudhës raportuese					30		69		
Cedim në kompetencë					17		25		
Numri i përgjithshëm i rasteve të zgjidhura të personave	33		96		107		135		1
Numri i përgjithshëm i rasteve të personave, të cilat ishin ende të pazgjidhura në fund të periudhës	36		21		157		189		14
Numri total i kallëzimeve penale të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese	10		10		113		141		6
Konfirmim i aktakuzës (Neni 316 paragrafi 4)	3		1						
Vendimet e gjykatave sipas personave									
Aktgjykim me urdhër ndëshkimor	2		2		1		2		
Aktgjykim për hedhje poshtë të akuzave					2		4		
Aktgjykim lirues			3		0		1		
Aktgjykim dënues	3		4		14		29		
Masa për trajtim të detyrueshëm					0		2		
Për shkaqe të tjera								1	0
Për shkak të parashkrimit	2		2		0		2		
Ankesat ndaj vendimeve të gjykatave									
Numri i përgjithshëm i ankesave të prokurorit në vendimet gjyqësore					1		3		
Numri total i ankesave të pranura nga gjykatat					1		1		
Numri total i ankesave të hedhura poshtë nga gjykatat					4		4		

Ekziston nevoja për hulumtime të mëtejme lidhur me mënyrën se si i trajton organi i ndjekjes penale në mënyrë specifike rastet e ngacmimit seksual. Duke marrë parasysh mungesën e informatave lidhur me këto raste, ka qenë e vështirë të bëhej një vlerësim i mënyrës se si prokuroria i ka trajtuar këto raste.¹⁴⁵ Për ta përmirësuar performancën në funksion të një adresimi më të mirë të rasteve të ngacmimit seksual, disa prokurorë kanë përmendur rëndësinë e pasjes së prokurorëve të cilët kanë trajnim të specializuar në adresimin e ngacmimit seksual.

Gjykatësit

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka Kodin e Etikës, i cili zbatohet për të gjitha organet gjyqësore në Kosovë.¹⁴⁶ Në të parashikohet se:

Gjatë ushtrimit të përgjegjësi gjyqësore, gjyqtari ka për detyrë që të sigurojë që ligji, përfshirë këtu edhe standardet e njohura ndërkombëtarisht, zbatohet në mënyrë të duhur dhe rastet trajtohen me drejtësi duke iu shmangur qëndrimit diskriminues kundër çdo personi apo personave mbi çfarëdo baze, duke përfshirë gjininë, moshën, statusin martesor, gjuhën, paafësinë mendore dhe fizike, orientimin seksual, përkatësinë apo bindjen politike, prejardhjen

¹⁴⁵ RrGGK-ja ka arritur të lokalizojë vetëm një rast specifik. Në vitin 2011, programi televiziv "Drejtësia në Kosovë" raportoi se dy vajza minorene, të moshës 10 vjeçare, ishin ngacmuar seksualisht nga një burrë më i rritur. Rasti i ishte raportuar policisë nga viktimat dhe kryerësi i pretenduar ishte arrestuar. Prokurori në Prizren vendosi të mos e ndiqte rastin dhe kryerësi i pretenduar u la i lirë. Informata të mëtejme lidhur me procedurën mund të gjenden në YouTube: Drejtësia në Kosovë, "Policia e Kosovës: Ngacmim seksual ndaj vajzave adoleshente", 21/3/2011, në adresën: <https://www.youtube.com/watch?v=H2TN3rWFh9s>, parë për herë të fundit më 21 janar 2016.

¹⁴⁶ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Kodi i Etikës dhe Sjella Profesionale për Gjyqtarët*, nr. 2001/8 i UNMIK-ut, Kosovë: 2001.

etnike, kombësinë, besimin ose fenë, racën, prejardhjen shoqërore, statusin pronësor, të lindjes apo çdo status tjetër.¹⁴⁷

Në paragrafin 3 përshkruhen ndëshkimet për gjyqtarët të cilët “për ndonjë arsye, ndiejnë se nuk janë në gjendje të veprojnë në pajtim me” këtë paragraf. Procedurat përfshijnë marrjen e “veprimit të menjëhershëm, duke përfshirë edhe heqjen dorë nga rasti dhe t’i kërkojë Kryetarit të Gjykatës ku ai/ajo shërben, ta përjashtojë atë nga rasti.”¹⁴⁸

Të pyetur nëse kanë ndonjë politikë lidhur me ngacmimin seksual në institucionin e tyre, gjyqtarët kanë prirje të përmendin këtë Kod të Etikës, i cili ndoshta interpretohet në mënyrë të përgjithshme për të mos e konsideruar ngacmimin seksual si formë të diskriminimit. Megjithatë, Kodi nuk e adreson në mënyrë eksplicite ngacmimin seksual dhe asnjë prej gjyqtarëve e intervistuar nuk ka mundur t’i referohet ndonjë rregulle apo procedure specifike të ndërlidhur me adresimin e ngacmimit seksual brenda institucionit të tyre. Asnjë gjyqtar nuk ka mundur të sjellë ndërmend ndonjë rast ku Kodi i Etikës është përdorur në ndonjë rast të ngacmimit seksual në institucionin e tyre.

Gjyqtarët priren të përmendin zbatueshmërinë e Kodit Penal për rastet e ngacmimit seksual më shumë sesa ligjet e tjera. Ata kanë prirje të mos jenë në gjendje të flasin me shumë hollësi lidhur me rastet e ngacmimit seksual.¹⁴⁹ Një gjyqtare tha se kjo ndodhte për shkak se ngacmimi seksual nuk klasifikohet si pjesë e kategorisë së rasteve gjyqësore civile (fusha e saj). Megjithatë, kjo është e pasaktë dhe tregon se ajo ka mungesë njohurish për Ligjin për Barazinë Gjinore dhe ligjet kundër diskriminimit. Mungesa e njohurive lidhur me kornizën përkatëse ligjore mund të minojë aftësinë e gjyqtarëve për të siguruar zbatimin e kësaj kornize.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës është kontaktuar për statistika lidhur me rastet e ngacmimit seksual, të adresuara nga gjykatat. Megjithatë, ky institucion nuk i gjurmon këto raste, meqenëse “ngacmimi seksual” nuk renditet si vepër penale e veçantë. Meqenëse gjyqtarët e intervistuar kishin pak ose aspak informata lidhur me rastet e ngacmimit seksual apo përvojë me këto raste, ka qenë e vështirë të analizohet mënyra se si gjykatat janë marrë me këto raste.¹⁵⁰ Kështu, i vetmi tregues i dobët i performancës së gjykatës, për shembull, është se 189 raste dhe 141 kallëzime penale lidhur me shkeljen e integritetit seksual, të parashtruara nga prokuroria në vitin 2014, mbeten të pazgjidhura, ndërkohë që gjykatat, sikurse tregohet në tabelën 3, kanë nxjerrë vetëm 40 vendime. Mospërputhshmëria e konsiderueshme midis kallëzimeve të bëra dhe rasteve të përfunduara nga gjykatat mund të japë të kuptohet se, midis shkaqeve të tjera të mundshme, ose prokurorët nuk kanë mbledhur të dhëna të mjaftueshme për të provuar se kanë ndodhur veprat penale, ose se ka mungesë të vullnetit për t’u marrë me këto raste.

Nga ato pak raste që janë përmendur nga gjyqtarët, në një rast, një vajzë nga Gjakova i kishte dërguar fotografi intime të dashurit të saj, i cili i kishte postuar ato në Facebook. Vajza tentoi të bënte vetëvrasje. Familja e saj është duke e hedhur në gjyq të dashurin e saj. Një gjykatës tha se gjykata do ta arrestojë atë.¹⁵¹ Në një rast tjetër të publikuar gjerësisht nga media, Kryetari i Kuvendit të Bashkësisë

“Kemi regjistrimin e vajzës së akuzon X për shembull, por çfarë u bë me këtë regjistrim? Shumë raste dëgjojmë, mirëpo nuk kam dëgjuar ndonjëherë që për ndonjë rast që ka shkuar në gjykatë të jetë dhënë ndonjë ndëshkim për ngacmim seksual.”

- Zyrtar për Ndihmë Juridike

¹⁴⁷ Ibid, pjesa A, paragrafi 2.

¹⁴⁸ Ibid, paragrafi 3.

¹⁴⁹ Intervista të RrGGK-së me gjyqtarë të ndryshëm në komuna të ndryshme, 2015.

¹⁵⁰ Intervista të RrGGK-së, 2015. Qytetarët që morën pjesë në anketim raportuan edhe raste të tjera për të cilat thanë se kishin rezultuar në burgimin e kryerësve. Për shembull, një i anketuar i RrGGK-së përmendi rastin e një “burri që kishte përdhunuar një vajzë 14-vjeçare nën kërcënimin e armës në xhami. Ajo mbeti shtatzënë dhe abortoi. Burri u mbajt në burg për dy vite dhe vajza u martua” (grua, 41 vjeç, Viti).

U përmend edhe një rast tjetër ku një vajzë ishte përdhunuar nga babai i saj përgjatë një periudhe prej dhjetë vitesh. Vajza mbeti shtatzënë dhe vëllai i saj informoi policinë. Babai u shpall fajtor dhe u dënua me shtatë vjet burgim (burrë, 40 vjeç, Gillogoc). Megjithatë, të dyja këto raste përfshijnë përdhunimin si vepër penale dhe jo domosdoshmërisht edhe ngacmimin seksual.

¹⁵¹ Intervista e RrGGK-së me një gjyqtar të gjykatës themelore në Gjakovë, 2015.

Islame është akuzuar për ngacmim seksual të studentëve të tij në shkollën e Medresesë “Alaudin”.¹⁵² Rasti i është raportuar policisë dhe ai është konsideruar i dyshuar derisa gjykata nxori një vendim. Megjithatë, lidhur me rezultatin e këtij rasti nuk janë raportuar informata të tjera. Një histori tjetër e publikuar në vitin 2013 jepte hollësi për rastin e një të moshuari i cili ngacmonte seksualisht një vajzë të mitur. Prokurori e ngarkoi me akuzë të dyshuarin,¹⁵³ mirëpo sërish rezultati nuk u raportua. Për fat të keq në dispozicion ka pak informata lidhur me atë nëse ka pasur të ndëshkuar për ngacmim (seksual) si vepër penale.

Mbrojtësit e Viktimave

Divizioni për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave është në kuadrin e Prokurorisë së Shtetit dhe, për këtë arsye, ndjek të njëjtin Kod të Mirësjelljes sikurse prokurorët, i cili është nxjerrë nga Këshilli Prokurorial i Kosovës. Procedura për raportimin e ndodhjes së rasteve të ngacmimit seksual brenda institucionit është kështu: punonjësi i ngacmuar e raporton rastin e tij tek menaxheri, menaxheri ia raporton rastin komisionit disiplinor, dhe informohet edhe policia.¹⁵⁴ Më pas, duhet të shkruajnë një kallëzim penal, të kërkojnë arrestim, hartojnë akuzën, dhe më pas të mbajnë seanca dëgjimore.

Mbrojtësit e Viktimave janë përgjegjës për të siguruar që të gjitha viktimat i kuptojnë shërbimet që ofron shteti dhe mënyrën e qasjes në këto shërbime. Mbrojtësit e Viktimave mund të përfaqësojnë viktimat dhe të kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të tyre.¹⁵⁵ Ndërkohë që historikisht ata kanë ndihmuar kryesisht personat që kanë vuajtur nga dhuna në familje dhe trafikimi, përgjegjësia e tyre më e gjerë për të ndihmuar viktimat, nënkupton se ata mund të ndihmojnë edhe persona të cilët kanë përjetuar ngacmim seksual.

Mbrojtësit e Viktimave duket se janë të informuar për ngacmimin seksual dhe mund ta dallojnë atë nga përdhunimi apo sulmi seksual. Një prej pengesave kryesore me të cilat Mbrojtësit e Viktimave thanë se përballen atëherë kur ndihmojnë personat që kanë vuajtur nga ngacmimi seksual, ka qenë frika që kanë viktimat për ta raportuar atë. Një Mbrojtës i Viktimave u shpreh: “Ngacmimi seksual nuk raportohet për shkak të frikës; frikës nga humbja e vendit të punës; frikës nga keqkuptimet në familje; frikës nga reagimi i bashkëshortit për shkak se ti e raporton atë; dhe frikës nga bërja objekt i thashethemeve.”¹⁵⁶

Kur trajtohen rastet e ngacmimit seksual, të raportuara në institucion, Mbrojtësit e Viktimave kanë thënë se ata i trajtojnë të gjitha rastet në pajtim me Kodin Penal dhe Kodin Penal për të Miturit. Ata rrallë herë përdorin ligje të tjera.

Sërish, meqenëse ngacmimi seksual nuk është renditur në mënyrë specifike si vepër penale, Mbrojtësit e Viktimave nuk e kanë gjurmuar numrin e rasteve në të cilat kanë dhënë ndihmën e tyre. Megjithatë, një dy Mbrojtës të Viktimave arritën të sillnin në mendje rastet ku kishin dhënë ndihmën e tyre. Një Mbrojtës i Viktimave në Prizren u shpreh se midis janarit dhe prillit të vitit 2015, në zyrën e tyre ishin raportuar nëntë raste. Pjesa më e madhe e rasteve ishin raportuar nga vajza të cilat ishin ngacmuar nga burra më të mëdhenj. Një rast i raportuar më së fundmi ka pasur të bëjë me rastin e një zyrtari komunal që ngacmonte seksualisht një vajzë 16 vjeçare. I akuzuari e humbi pozitën e tij zyrtarë.¹⁵⁷ Mbrojtësit e Viktimave u pyetën edhe lidhur me atë nëse kishin qenë dëshmitar të ndonjë rasti ku viktimat ishin kompensuar për dëmet, megjithatë asnjë prej tyre nuk kishte parë apo dëgjuar ndonjëherë për raste të tilla.

Institucioni i Avokatit të Popullit

Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë, mbështetur në Ligjin për Barazinë Gjinore, “është institucion i barazisë që trajton rastet që lidhen me diskriminimin gjinor, në përputhje me procedurat e

¹⁵² Gazeta Express “Hasani hesht për ngacmimet seksuale”, gusht 2013, marrë nga: <http://www.gazetaexpress.com/arkiva/hasani-hesht-per-ngacmimet-seksuale-119947/>

¹⁵³ Telegrafi.com, “Akuzohet për ngacmim seksual të së miturës”, 2013, marrë nga: <http://www.telegrafi.com/lajme/akuzohet-per-ngacmim-seksual-te-te-mitures-80-5331.html>.

¹⁵⁴ Intervistë e RrGGK-së me një Mbrojtës të Viktimave, 2015.

¹⁵⁵ Kodi Penal i Kosovës, 2013 dhe Kodi i Procedurës Penale.

¹⁵⁶ Intervistë e RrGGK-së me një Mbrojtës të Viktimave, 2015.

¹⁵⁷ Intervistë e RrGGK-së me një Mbrojtës të Viktimave, Prizren, maj 2015.

parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit.”¹⁵⁸ Sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Institucioni i Avokatit të Popullit është “institucion i shtetit, i cili bën promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Avokati i Popullit trajton rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin sipas ligjit përkatës për Avokatin e Popullit.”¹⁵⁹ Kësisoj, Institucioni i Avokatit të Popullit ka përgjegjësi ligjore për të pranuar, hetuar dhe trajtuar rastet që lidhen me ngacmimin seksual.

Me aq sa dinë zyrtarët, në këtë institucion janë raportuar vetëm tri prej këtyre rasteve.¹⁶⁰ Një rast kishte bërë bërë me ngacmim seksual në vendin e punës. Një grua shkoi për intervistë në një zyrë postare dhe drejtori i kërkoi favore seksuale në këmbim të punës. Pas shqyrtimit të rastit, Avokati i Popullit e pyeti atë nëse dëshironte të ngrinte akuzë dhe ta informonte institucionin ditën e nesërme:

Gruaja e martuar, me dy a tre fëmijë, erdhi në zyrë e nervozuar. S’kishte qenë ndonjëherë kështu më përpara. Megjithatë, unë e dija që në fund të fundit kjo do të kishte pasojë sepse bashkëshorti nuk do t’i besonte për gjykimin apo përvojën. Në vend që ta zgjidhje problemin, krijoi dy probleme. Kështu që i thashë asaj [...] do të presim për telefonatën tënde dhe ti do të na thuash të vazhdojmë me rastin. Ne na duhet konfirmimi yt që të sigurohemi që nuk krijojmë ndonjë situatë që mund të ketë pasojë. Dhe s’kam për ta harruar që të nesërmen, në orën 10 të mëngjesit, na mori në telefon. Pasi kishte qenë në shtëpi [dhe] ishte qetësuar, e kishte parë se çfarë lloj rrjedhosh mund të krijoheshin dhe vendosi që të mos vazhdonte më tej.

Këtu, duket se Avokati i Popullit e ka këshilluar tërthorazi gruan që të hiqte dorë nga akuzat. Ky incident ndoshta bën që të shtrohet pyetja lidhur me atë nëse Avokati i Popullit është duke bërë çdo që ka në autoritetin e tij për të mbrojtur gratë nga këto rrjedhoja të mundshme dhe për t’i mbështetur si duhet gratë të cilat kërkojnë t’i parashtrijnë raste të tilla, duke iu ofruar atyre këshilla lidhur me të gjitha opsionet e mundshme të disponueshme.

Rasti i dytë kishte të bënte me një grua e cila ishte duke zgjidhur të drejtat në kujdestari në një gjykatë. Meqenëse ky proces po zgjaste ca kohë, gjykatësi premtoi se do t’i përshpejtonte procedurat nëse ajo do të dilte për të pirë një kafe me të. Gruaja vendosi që këtë rast të ngacmimit seksual ta çonte në gjykatë. Në marrëveshje me Avokatin e Popullit, gruaja fshehu në kuletën e saj një pajisje regjistrimi dhe e regjistroi seancën gjyqësore të radhës me të njëjtin gjykatës. Ky regjistrim provoi se kishte pasur ngacmim seksual dhe gruaja e fitoi rastin. Si pasojë e kësaj, gjyqtari u pezullua. Në këtë rast, Avokati i Popullit i realizoi përgjegjësitë e tij në mënyrë efektive. Megjithatë, sipas Avokatit të Popullit, njerëzit rrallë herë i çojnë këto raste në gjykatë.

Përfundime

Disa përfaqësues të institucioneve ende nuk kanë njohuri lidhur me ngacmimin seksual, përkufizimin e tij dhe kornizën ligjore përkatëse. Kjo gjë e pengon aftësinë e tyre për t’iu përgjigjur me efektivitet rasteve të ngacmimit seksual. Ngacmimi seksual ka prirje të keqkuptohet si përdhunim apo sulm seksual, ndërkohë që format “më pak serioze” ose “serioze” të ngacmimit seksual janë ose të panjohura ose konsiderohen si jo shumë të rëndësishme. Krahë kësaj, disa përfaqësues të institucioneve, njëloj sikurse bashkë-qytetarët e tyre, kanë prirje të fajësojnë viktimat për ngacmimin seksual. Kjo, së bashku me marrëdhëniet e përhapura pushtetit, të përmendura më sipër, midis abuzuesit dhe të abuzuarit, kontribuojnë në frikën që kanë viktimat për të raportuar rastet e ngacmimit seksual. Nëse rastet nuk raportohen në institucione, institucionet nuk mund t’i trajtojnë ato në mënyrë efektive. Fakti që janë raportuar kaq pak raste, së bashku me mungesën e përkufizimit eksplicit të ngacmimit seksual në kodin penal, e vështirëson gjurmimin dhe vlerësimin e prirjeve në reagimin institucional.

¹⁵⁸ Ligji i Kosovës për Barazinë Gjinore, nr. 05/L-020, neni 13.

¹⁵⁹ Ligji i Kosovës për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nr. 05/L-021, neni 9.

¹⁶⁰ Intervistë e RrGGK-së me Institucionin e Avokatit të Popullit, 2015.

REKOMANDIME

Për Qeverinë e Kosovës dhe të gjitha institucionet

- Të bëhet nisja e ndryshimeve në dispozitat e Kodit Penal të Kosovës, në lidhje me ngacmimin, si dhe të bëhet inkorporimi i një përkufizimi specifik, konciz dhe të qartë të ngacmimit seksual, në harmoni me standardet për të drejtat e njeriut në KEDKG dhe BE, të cilat janë të aplikueshme drejtpërdrejt në Kosovë.
 - o Të ripërkufizohet “ngacmimi” në Kodin Penal me këtë formulim: “Çdo akt i padëshiruar, vëmendje apo komunikim, që e vë personin tjetër nën mbikëqyrje; e ngacmon atë; e kërcënon; e lëndon; ia dëmton pasurinë; përfshin kërcënime për dëmtimin e pasurisë, lëndimin, apo vrasjen e një personi tjetër ose një anëtarë familjeje të atij personi, apo kafshën e përkëdhelur të tij/saj; dhe/ose e vë personin tjetër në një situatë të frikës së arsyeshme nga vdekja, lëndimeve të rënda trupore, dëmtimit të pronës, apo të shqetësimeve emocionale. Vëmendja apo komunikimi përfshin: qëndrimin në pritje, shfaqjen e përsëritur në shtëpi, shkollë, vendin e punës apo ndonjë vend për çlodhje; bërjen e telefonatave të përsëritura; dërgimin apo lënien e mesazheve, duke përfshirë edhe ato përmes medias sociale; dërgimin e mesazheve tekst, letrave postare apo e-mailit, ose lënien apo dërgimin e dhuratave apo artikujve të tjerë të padëshiruar.” Më pas, duhet të bëhet kujdes që ligji civil përkatës të jetë në harmoni.
 - o Të përkufizohet në mënyrë eksplicite “ngacmimi seksual” në Kodin Penal si: “Ngacmim seksual: çdo formë e sjelljes verbale, joverbale, vizuale apo fizike e një natyre seksuale, e cila përfshin por nuk kufizohet vetëm në: gjuhë të pahijshme, komente nënçmuese, afrime seksuale, kërkesa për favore seksuale, ndjekje, fishkëllimë, prekje, thirrje, postim të fotografive, dhe dërgim i mesazheve përmes telefonit, mediave sociale, postës ose postës elektronike. Në të bëjnë pjesë të gjitha aktet e një natyre seksuale të cilat kanë për qëllim apo synim të cenojnë dinjtetin e një personi ose të krijojnë një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues, ose fyerës.” Më pas, duhet të bëhet integrimi i shumësisë së ligjeve, duke siguruar kështu që të gjitha ligjet relevante civile të jenë në harmoni.
- Të krijohet një procedurë e vetme dhe e qartë për të gjitha pretendimet për shkelje lidhur me ngacmimin seksual. Të bëhet kujdes që të gjitha ligjet përkatëse të ndërlidhen me procedurat e ngjashme për të gjitha rastet, duke përfshirë ato që mbulohen në klauzolat kundër diskriminimit dhe ato të barazisë gjinore.
- Rregullorja nr. 04/2011 duhet të parashikojë një kalim të “barrës së provës” në rastin e ankesave për ngacmim seksual, sikurse kërkohet me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Të qartësohet në Kodin Penal përkufizimi i asaj se çka përbën keqtrajtim nga personat që ushtrojnë detyrat zyrtare (neni 198) dhe se si mund të cenohet në mënyrë më specifike dinjteti i një personi.
- Në pajtim me Ligjin për Barazinë Gjinore dhe Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të nxirren menjëherë udhëzime administrative si akte nën-ligjore. Me anë të këtyre akteve duhet të detyrohen institucionet e arsimit dhe të shëndetësisë që të kenë procedura të qarta lidhur me mënyrën e parashtrimit të ankesave për ngacmime seksuale dhe mënyrën se si merren vendimet, nga aspekti procedural. Çdo institucion shtetëror duhet të inkurajohet që të hartojë dhe miratojë edhe politika të brendshme kundër ngacmimit seksual.
- Kompensimi i viktimave të ngacmimit seksual duhet të pohohet në mënyrë të qartë dhe të jetë proporcional me dëmin e shkaktuar dhe të vuajtur nga viktimat e ngacmimit seksual, brenda kuadrit të Ligjit për Kompensimin. Aktualisht, Ligji për Kompensimin e ka vështirësuar kompensimin dhe e ka bërë edhe më të paqartë në rastin e procedurave për viktimat e ngacmimit seksual.
- Të bëhet mbledhja, analizimi dhe raportimi lidhur me raportet për rastet e lidhura me diskriminimin, duke përfshirë rastet e diskriminimit me bazë gjinore dhe ato të ngacmimit seksual, në harmoni me kërkesat e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ato të Ligjit për Barazinë Gjinore. Këtu përfshihet mirëmbajtja dhe raportimi i të dhënave statistikore të kategorizuara sipas gjinisë, lidhur me rastet, procedurat dhe vendimet në rastet e diskriminimit dhe ngacmimit (seksual), si dhe informatat lidhur me kompensimin e dhënë dhe gjokat e arkëtuara. Agjencia për Barazi Gjinore

duhet të kujdeset që këto raporte të vihen në dispozicion të publikut dhe të publikohen çdo vit në faqen e tyre në internet.

- Në Strategjinë e re Nacionale dhe Planin e Veprimit, në drejtim të zbatimit të Ligjit të ri për Barazinë Gjinore dhe/ose Strategjinë e re Nacionale dhe Planin e Veprimit për të Drejtat e Njeriut, duhet të përfshihet:
 - Trajnimi i detyrueshëm për ngacmimin seksual, përkufizimi dhe format e tij, si dhe korniza ligjore përkatëse për të gjitha institucionet e Kosovës. Kjo do të mund të ofrohet nga Instituti Kosovar për Administratën Publike si pjesë e kurrikulës së re për barazi gjinore dhe/ose si pjesë e trajnimit të detyrueshëm hyrës, të ofruar nga institucionet, lidhur me Kodet e Mirësjelljes dhe politikatat e tjera.
 - Një fushatë sensibilizuese, e koordinuar nga Agjencia për Barazi Gjinore, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet përkatëse dhe OSHC-të që kanë ekspertizë, me qëllim që të sensibilizojnë qytetarët për përkufizimin e ngacmimit seksual, të drejtat e tyre, mënyrën dhe vendin ku ta raportojnë atë.

Për Policinë e Kosovës

- Të sigurohet që të gjithë zyrtarët policorë të mirë-trajnohen lidhur me përkufizimin e ngacmimit seksual sipas ligjeve të Kosovës, atë se çfarë përfshihet në të, si dhe lidhur me mënyrën e trajtimit të këtyre rasteve kur këto raportohen. Këtu bëjnë pjesë teknikat që përdoren në intervistim.
- Të sigurohet që politikatat që kanë të bëjnë me mënyrën se si raportohet ngacmimi seksual në polici të jenë të qarta dhe të publikuara mirë.

Për Ministrinë e Drejtësisë

- Të ndryshohet Ligji për Kompensimin, me qëllim që viktimat e ngacmimit seksual të përfshihen në mënyrë eksplicite dhe kompensimi i tyre të jetë proporcional me dëmin e shkaktuar dhe të pësuar nga ngacmimi seksual.

Për Prokurorinë

- Duhet të trajnohet një grup kuadrosh (prokurorë) në mënyrë të veçantë për adresimin e ngacmimit seksual dhe të formave të tjera të dhunës seksuale.
- Divizioni për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave në kuadër të Zyrës së Prokurorit mund ta përfshijë në mënyrë eksplicite ngacmimin seksual në Termat e saj të Referencës, duke përfshirë personat që përgjigjen në numrin e ndihmës. Kjo duhet të pasohet nga trajnimi i detyrueshëm për përkufizimet ligjore të ngacmimit seksual si dhe nga procesi për referimin e rasteve.

Për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Inspektorati i Punës

- Të sigurohet që të gjithë inspektorët e punës të trajnohen për ngacmimi seksual, përkufizimin e tij ligjor si dhe mënyrën e referimit të rasteve.

Për Kuvendin e Kosovës

- Komitetet përkatëse të përhershme në Kuvendin e Kosovës, domethënë Komiteti i Kuvendit për Integritet Evropian dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, duhet të monitorojnë në mënyrë të rregullt zbatimin e ligjeve të reja kundër diskriminimit dhe barazisë gjinore. Kuvendi duhet të luajë një rol në monitorimin e asaj nëse ligjet janë më të qasshme dhe, në rast të miratimit, procedurat e shqyrtuara e kanë lehtësuar përdorimin e legjislacionit për viktimat e diskriminimit, diskriminimit me bazë gjinore, dhe ngacmimit seksual.

Për Shoqërinë Civile

- Të vazhdohet monitorimi i rregullt i rasteve të ngacmimit seksual në Kosovë

- Të rritet sensibilizimi lidhur me dispozitat ligjore të disponueshme dhe kompensimin që ofrohet për viktimat e ngacimit seksual dhe format e tjera të diskriminimit dhe diskriminimit me bazë gjinore.
- Të avokohet për zbatim.
- Të mbështeten veprimet e klasës dhe proceset gjyqësore strategjike me qëllim që të sigurohet zbatimi efektiv i legjislacionit përkatës.

Shtojca 1. Metodologjia e hulumtimit

Aneksi paraqet hollësi të mëtejshme lidhur me metodologjinë e hulumtimit. Për t'iu përgjigjur pyetjeve të hulumtimit, të cilat janë përvijuar në hyrjen e këtij studimi, hulumtimi ka përdorur metoda të përziera: 1) është shqyrtuar korniza ligjore për identifikimin e hendeqeve në kornizën ligjore dhe zbatimin e saj; 2) është realizuar një anketim kombëtar i amvisave me 1,315 qytetarë, për matjen e vetëdijesimit, qëndrimeve dhe incidencës së dhunës në familje; 3) janë realizuar intervista me përfaqësues të rreth 200 institucioneve dhe organizatave; janë shqyrtuar të dhënat statistikore të mbledhura nga institucionet përkatëse. Më poshtë jepen hollësi të mëtejshme.

Anketimi

Të dhënat sasiore janë mbledhur përmes anketimit në shtëpi të individëve, i cili është realizuar në gjithë Kosovën. Instrumenti i anketimit përmbante kryesisht pyetje me fund të mbyllur dhe ishte i ngjashëm me instrumentin anketues të vitit 2008, me qëllim që të mundësohej krahasimi (shihni Aneksin 3 Pjesa më e madhe e pyetësorëve, të cilët janë plotësuar përmes intervistave ballë për ballë, kanë zgjatur afërsisht gjysmë orë, edhe pse një sondazh zgjati pak më pak sesa dy orë. Kohëzgjatja mesatare e intervistave ka qenë 35 minuta, me një devijim standard prej 12 minutash.

Anketimi është paratësuar përpara anketimit real në zonat rurale dhe urbane të Prishtinës. Kjo i ka mundësuar ekipit të hulumtimit të shohë nëse instrumenti i sondazhit është dizajnuar si duhet dhe nëse qytetarët e kuptonin atë. Duke u mbështetur në këtë pilotim, janë bërë edhe disa modifikime të vogla.

Anketuesit: Anketuesit janë përzgjedhur në bazë të formimit të tyre arsimor, shkathtësitë e komunikimit, shkathtësitë profesionale, etikën dhe gatishmërinë e tyre për t'u bërë pjesë e hulumtimit. Kryesisht anketuesit ishin studentë të psikologjisë dhe sociologjisë. Për intervistimin e grupeve të ndryshme, RrGGK-ka ka përfshirë edhe anketues nga grupet etnike minoritare, të cilët flisnin shumë gjuhë. Anketuesit kanë qenë të ekuilibruar nga pikëpamja gjinore. Duke mbajtur parasysh ndjeshmërinë e çështjes, gratë kanë intervistuar gratë ndërsa burrat kanë intervistuar burrat. Lista e anketuesve është paraqitur në pjesën e mirënjohjes të këtij hulumtimi.

Trajnimi i anketuesve: Për të gjithë anketuesit është zhvilluar një trajnim i detyrueshëm dy-ditor. Trajnimi ka siguruar që anketuesit ta njohin mandatin e hulumtimit, instrumentin e anketimit, procedurat e kontrollit dhe logistikën. Një pjesë tjetër e rëndësishme e trajnimit ka qenë edhe rëndësia e ruajtjes së sigurisë dhe mirëqenies emocionale të respondentëve, si dhe mënyra e menaxhimit të situatave të ndryshme të cilat mund të krijoheshin gjatë anketimit, për shembull shfaqja e shenjave të traumave nga respondentët ose ndërhyrjet e anëtarëve të familjes. Veç kësaj, trajnimi është përqendruar në etikën e anketuesve, duke marrë parasysh çështjen e ndjeshme me të cilën merret ky hulumtim.

Mostra e hulumtimit: RrGGK-ja ka anketuar 1,315 qytetarë të të gjitha grupeve etnike dhe të moshës 18 vjeç e sipër. RrGGK-ka ka përzgjedhur një mostër të rastësishme të popullatës së Kosovës. Mostra ka përfshirë banorë të zonave rurale dhe urbane dhe 181 pika monstri të përzgjedhura në mënyrë rastësore në 132 vendbanime në 36 komuna. Mostra përfaqëson gjithashtu edhe të gjitha grupet etnike në Kosovë, duke qenë se përzgjedhja është bërë duke përdorur metodën e mostrimit rastësor me shumë shkallë. Ndarja në strate e respondentëve është bërë mbi bazën etnike dhe rajonale. Kuotat e mostrimit janë caktuar duke përdorur të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, të prillit të vitit 2011, të siguruar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK).¹⁶¹ Mostra e përgjithshme është ndarë në tri nën-grupe: nën-grupi i shqiptarëve, nën-grupi i serbëve dhe nën-grupi i grupeve të tjera etnike. Më pas, mostra është stratifikuar sipas rajonit dhe profilit banesor (urban/rural) të secilit rajon.

¹⁶¹ ASK, *Atlasi i Regjistrimit të Popullsisë Kosovë 2011*, Prishtinë: ASK, 2013, marrë nga: <https://ask.rks-gov.net/ser/images/files/Atlas%20popisa%20stanovnistva%20Kosovo.pdf>.

Mostra është përbërë nga shqiptarë, serbë të Kosovës dhe grupet minoritare jo-serbe në Kosovë (minoriteti turk, boshnjak, goran, romë, ashkali dhe egjiptian). Parimet e stratifikimit kanë qenë të njëjta për të trija grupimet etnike. Për të siguruar numrin e mjaftueshëm të anëtarëve nga secili nëngrup i caktuar i popullatës, me qëllim që të bëheshin vlerësime të besueshme lidhur me atë grup, RrGGK-ja i ka mbi-mostruar serbët e Kosovës dhe grupet e tjera minoritare. Të dhënat më pas janë peshuar gjatë analizimit me qëllim që kjo të merrej parasysh.

Në mënyrë rastësore, sipas teknikës së ditëlindjes më të afërt, nga çdo familje janë përzgjedhur respondentë të moshës 18 vjeç e sipër. Kjo natyrshëm krijon një shpërndarje proporcionale të grave dhe burrave, në mënyrë të ngjashme me shpërndarjen në popullatë. Sipas ASK-së, 50.3% e popullsisë janë burra ndërsa 49.7% janë gra.

Procesi i intervistimit: Anketimi është kryer nga data 19 deri me 28 shkurt. Nga 1,315 individë të anketuar, 20 nuk kanë mundur ose refuzuan ta plotësonin të gjithë atë. Në shtatë raste, intervista është lënë në mes sepse respondentët nuk kishin kohë të vazhdonin. Në pesë raste, respondentët thjesht refuzuan të vazhdonin. Tre respondentë nuk mundën të përfundonin për shkaqe të ndryshme, duke përfshirë moshën e madhe, sëmundjen, ose ndalimin nga dikush tjetër. Ka pasur edhe katër raste ku të intervistuarit nuk ishin të gatshëm psikologjikisht për ta vazhduar intervistën, gjë e cila pritet me intervistat që kanë të bëjnë me informata të një natyre kaq të ndjeshme dhe private. Në përgjithësi, e gjithë intervista dhe anketa është plotësuar nga 98.4% të pjesëmarrësve.

